



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Integruar i Studimit të Ciklit të Dytë në: “Arkitekturë” me profile
“Arkitekturë interieri”, “Urbanistikë”
Universiteti European i Tiranës**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.As.Dr. Gjergji Islami

Prof.As.Dr. Teuta Jashari Kajtazi

Shkurt / 2024


TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi i Integruar i Studimit të Ciklit të Dytë në: “Arkitekturë” me profile “Arkitekturë interieri”, “Urbanistikë”

1	IAL aplikues:	Universiteti European i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Programi i Integruar i Studimit të Ciklit të Dytë në: “Arkitekturë” me profile “Arkitekturë interieri”, “Urbanistikë” *
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 570, datë 12.09.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	300 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	v.a 2018-2019 9/2 v.a 2019-2020 13/3 v.a 2020-2021 17/6 v.a 2021-2022 18/8 v.a 2022-2023 20/13
18	Numri i studentëve:	<u>Profili Arkitekturë interieri:</u>

		2018-2019 2 2019-2020 29 2020-2021 27 2021-2022 38 2022-2023 45 <u>Profili Urbanistikë:</u> 2018-2019 3 2019-2020 5 2020-2021 13 2021-2022 3 2022-2023 7
19	Komente / të tjera:	Procesi i vlerësimit të jashtëm vlen vetëm për 2 (dy) profile

**Emërtimi i programit të studimit është me 5 (pesë) profile, por UET nëpërmjet shkresës me Nr.42/1 Prot, datë 02.11.2022, kërkon akreditim vetëm për 2 (dy) profilet që janë aktive, profilet "Arkitekturë interieri", dhe "Urbanistikë"*

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Integruar i Studimit të Ciklit të Dytë në: “Arkitekturë” me profile “Arkitekturë interieri”, “Urbanistikë”, ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, njësia bazë në Fakultetin e Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës të Universitetit Europian të Tiranës.

Ky program studimi është licensuar me Urdhër MASR Nr. 570, datë 12.09.2018, si Program i Integruar i Studimit të Ciklit të Dytë në: “Arkitekturë” me profile “Arkitekturë Interieri”, “Urbanistikë”, “Restaurim Monumentesh”, “Administrim Territori” “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”. Universiteti Europian i Tiranës nëpërmjet shkresës me Nr. 42/1 Prot, datë 02.11.2022, *“Dërgohen profilet aktive në programet e studimit në process akreditimi”*, kërkon akreditim të këtij programi vetëm për dy profile që janë aktive konkretisht: “Arkitekturë interieri”, dhe “Urbanistikë”

Programi i studimit realizohet me me 300 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë me kohëzgjatje normale 5 vite akademike në përfundim të të cilit lëshohet diplomë Master Shkencor në “Arkitekturë” me profile “Arkitekturë interieri”, dhe “Urbanistikë”.

Qëllimi i këtij Programi është përgatitja e arkitektëve në dy profile, në Arkitekturë interieri, si dhe Urbanistikë. Bazuar në planprogramin e ofruar shihet mundësia e profilizimit të studentit duke filluar nga viti i tretë i studimeve për të përfunduar me punim të diplomës në profilin përkatës.

Plan programi përmban lëndë të grupuara në: lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinare si dhe lëndë plotësuese, të cilat japin mundësinë e marrjes së njohurive bazë në fushën e arkitekturës dhe urbanistikës, si dhe profilizimin në dy profilet e lartpërmendura.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Raporti është përgatitur nga një grup ekspertësh të vlerësimit, njohur si Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), ngritur nga ASCAL, në përputhje me dispozitat ligjore të MASR dhe ASCAL. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë caktoi: Prof.As. Gjergji Islami dhe Prof.As. Teuta Jashari Kajtazi, si ekspertë të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit. Gjatë vizitës në institucion dhe procedurës lidhur me vlerësimin e jashtëm, ekspertët e jashtëm u asistuan nga përfaqëuesit e ASCAL Erion Xhako dhe Arbri Ndreka.

Pas rishikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga IAL lidhur me Programin e Integruar të Studimit Master i Shkencave në “Arkitekturë” me profile “Arkitekturë interieri” dhe “Urbanistikë”, Grupi i vlerësimit të jashtëm ka zhvilluar vizitë dy ditore në Institucionin në datat 4 dhe 5 Korrik, sipas Agjendës së paralajmëruar. Vizita është karakterizuar me njohjen më të përafërt me procesin e realizimit të deritanishëm të programit në proces akreditimi, përfshirë stafin përgjegjës akademik, studentët, stafin mbështetës administrativ, shërbimin e studenteve, infrastrukturën përkatëse, etj. Bisedat dhe diskutimet në lokacion kanë dhënë mundësinë e plotësimit të të dhënave të duhura në mbështetje të realizimit të vlerësimit të jashtëm të Programit në fjalë. Është kërkuar dokumentacioni shtesë, i plotësuar më pas nga Institucioni.

Raporti në vijim interpreton rezultatin i cili del nga analiza e dokumentacionit në njërën anë dhe vizitës në IAL në tjetrën anë, të cilat së bashku japin mundësinë e vlerësimit sa më real të Programit aktual në proces të akreditimit.

Universiteti Europian i Tiranës është njohur me DRVJ më datë 10.01.2024 përmes sistemit AMS, e në formë zyrtare me shkresë Nr.40 prot. datë 10.01.2024. Universiteti dërgoi në datë 18.01.2024 përmes sistemit AMS, e në formë zyrtare me shkresë Nr.1/1 prot datë 18.01.2024, Nr.40/1 prot i ASCAL datë 18.01.2024, që pranon gjetjet nga e GVJ dhe në këtë mënyrë DRVJ merr formën përfundimtare në RVJ.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në Arkitekturë - Program i Integruar me profile “Arkitekturë interieri” dhe “Urbanistikë”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti Europian i Tiranës ofron Programe të ndryshme studimi të cilat mbulojnë një numër të fushave profesionale në nivel të diplomës profesionale, nivelit Bachelor, si dhe të nivelit Master, të cilat mund të konsiderohen të balancuara në raport me kërkesat e tregut dhe të interesit të përgjithshëm dhe konform legjislaturës në fuqi. Shih: https://uet.edu.al/rreth-uet/
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i Studimit “Master i Shkencave” në Arkitekturë - Program i Integruar me profile “Arkitekturë interieri” dhe “Urbanistikë”, fillimisht është planifikuar me një numër më të madh të profileve, përfshirë “Restaurim monumentesh”, “Administrim territori” dhe “Menaxhim dhe vlerësim projektesh” (urdhër nr.570 të dates 12.09.2018), për të vazhduar dhe realizuar vetëm dy profile me të cilat aplikohet për akreditim. Në raport me këtë, dy profilet të cilat ofrohen konsiderohen në përputhje me misionin e IAL në fushën e arkitekturës.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	Programi është pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, dhe është hartuar në përputhje me fushat akademike të IAL, më konkretisht fushën e arkitekturës dhe urbanistikës.
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të	Programi i integruar i studimit Master i shkencave në Arkitekturë është program 5-vjeçar, me përmbajtje dhe kohëzgjatje të kërkuar për profesionin e Arkitektit, në rastin konkret të

zhvillimit, interesit kombëtar dhe prijet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	profilizuar në Arkitekturë interieri dhe Urbanistikë, si në tregun vendas ashtu edhe atë ndërkombëtar.			
Konkluzione	<i>IAL ofron Programe të ndryshme studimi të cilat mbulojnë një numër të fushave në nivel të diplomës profesionale, nivelit Bachelor, si dhe të nivelit Master, të cilat mund të konsiderohen në përputhje me misionin dhe qëllimin, si dhe të balancuara në raport me kërkesat e tregut dhe të interesit të përgjithshëm dhe konform legjislaturës në fuqi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Universiteti Europian Tiranës vepron nga viti 2006, derisa Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës që nga viti akademik 2018-2019. Departamenti i Arkitekturës vepron po nga i njëjti vit akademik. Stafit akademik i cili është prezentuar, si në materialin e bashkëlidhur ashtu edhe gjatë vizitës në lokacion, është i përgatitur në aspektin profesional dhe ai akademik, gjë që mbështetë përvojën dhe kapacitetet e duhura për mbarëvajtje të programit në fushën e arkitekturës.
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të	Bazuar në shkresën dërguar Ministrisë së Arsimit me datë 31/03/2023, vërehet reagimi/veprimi i UET në raport me kërkesën për kodifikim dhe klasifikim të programeve të cilat ofrohen në institucion dhe të cilat janë sipas direktivave kombëtare dhe ndërkombëtare (<i>shih aneksin 53.5</i>)

programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.									
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi ofrohet nga Departamenti i Inxhinerisë dhe Arkitekturës, i cili është njësi e Fakultetit të Inxhinerisë, Informatikës dhe Arkitekturës. Si i tillë konsiderohet në përputhje me fushën akademike të njësive bazë të cilat janë përgjegjëse për programin e studimit.								
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Nuk aplikohet në rastin e Programit në proces të akreditimit!								
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Departamenti Inxhinerisë dhe Arkitekturës ofron trajnime profesionale në disa fusha siç është specifikuar në shtojcën/aneksin e bashkëlidhur në dokumentacion, dhe ate: Ekspertizë hartografike dhe ligjore në kadastër; Vlerësues i Pasurive të Paluajtshme; si dhe Auditues Energjetik në Ndërtesa. (shih shtojcën/aneksin 33.1)								
Konkluzione	<i>Programi i integruar i studimit Master në Arkitekturë, ofrohet nga Departamenti i Inxhinerisë dhe Arkitekturës, i cili është njësi e Fakultetit të Inxhinerisë, Informatikës dhe Arkitekturës. Si i tillë konsiderohet në përputhje me fushën akademike të njësive bazë të cilat janë përgjegjëse për programin e studimit.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Përgjegjësitë dhe ndarja e detyrave të caktuara lidhur me mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e Programit të integruar në Arkitekturë përcaktohen në kuadër të Rregullores së UET (<i>shih aneksin 5</i>) si dhe Dokumentit për funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit (<i>shih aneksin 6</i>). Po ashtu edhe gjatë takimit në Institucion janë theksuar përgjegjësitë në fjalë.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e bashkëlidhur si dhe bisedave të zhvilluara në lokacion, IAL në përgjithësi, si dhe lidhur me Programin e integruar në Arkitekturë në veçanti, tregon marrëveshjet të cilat mbulojnë këtë kriter. Marrëveshjet apo memorandumet e prezentuara ndahen në bashkëpunime me Universitetet ndërkombëtare, Universitetet vendore, Institucionet e shoqërisë civile dhe ndërkombëtare, si dhe kompanitë e ndryshme profesionale në fushat relevante të studimit.</p> <p>(<i>shih anekset: 34-34.16</i>)</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon</p>	<p>Siç është përmendur në kriterin më sipër, janë marrëveshjet e nënshkruara të cilat mundësojnë realizimin e praktikave profesionale, projekteve të ndryshme kërkimore në fusha të cilat mbulohen në kuadër të Institucionit, derisa rezultati i këtyre veprimeve mund të shihet në dokumentet e bashkëlidhura të cilat tregojnë një grup projektesh të cilat mbulojnë disa fusha e ndër to edhe arkitekturën, mjedisin, energjinë e rinovueshme. Po ashtu, mund të përmenden dy projekte të veçanta të cilat përfshijnë pjesëmarrjen e mësimitdhënësve dhe studentëve, siç janë: studimi mbi tipologjinë e shkollave në kuadër të projektit “ Instituti Pashko”, si dhe Tradita pedagogjike dhe akademike e</p>


me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	shkollave profesionale ne Shqipëri (vitet 20-30 te Shekullit XX) (shih anekset: 28.1 dhe 28.5)			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Raporti i përgatitur nga IAL për periudhën Tetor 2018-Mars 2023 tregon përfitimet e arritura nga nënshkrimi i marrëveshjeve të cilat mundësojnë realizimin e kriterëve si më sipër dhe janë të dukshme në dokumentin e bashkëlidhur. Raporti ndër të tjera tregon: Realizimin e praktikave profesionale (internshipeve); Promovimin e programit të studimit dhe profesionistëve të ardhshëm të diplomuar në UET (Open weeks); Feedback mbi kërkesat e tregut të punës, njohuritë e kërkuara dhe zhvillimet më të fundit të fushës; Realizimin e orëve mësimore me personel akademik të ftuar, profesionistë të fushës; Partnership në kuadër të kërkimit shkencor, zhvillimit të projekteve të përbashkëta, shkëmbimit studentor dhe të stafit akademik; Mobilitetin e studentëve Erasmus +; (shih ankesin 35).			
Konkluzione	<i>Dokumentacioni i ofruar në formë të anekseve tregon një numër të theksuar të bashkëpunimeve në fushat të cilat ky standard i kërkon. Ndër të tjera janë prezentuar projektet dhe pjesëmarrja në aktivitet shkencore, si të stafit akademik ashtu edhe me përfshirje të studentëve në këto aktivitete.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i integruar në “Arkitekturë” përmban lëndë të grupuara në: lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinare si dhe lëndë plotësuese të cilat vlerësohen sipas Sistemit Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS kredi). Programi ka kohëzgjatje 5 vite me totalin prej 300 ECTS kredite, të ndara nga 60 ECTS kredi për një vit akademik. E gjitha në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe në përputhje me kërkesat e profesioneve të rregulluara, në rastin konkret, atë të Arkitektit.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Planprogrami i ofruar përmban në vete lëndë të grupuara, më saktësisht: lëndët bazë (si: shkrim akademik, matematikë, gjeometri deskriptive, histori arti), lëndët karakterizuese (si: vizatim, baza të projektimit, histori arkitekture, CAD, shkenca të konstruksioneve, teknologji arkitekture, projektim, restaurim arkitektonik), si dhe lëndë ndërdisiplinare/ integruese, me qëllim të formëzimit të studentëve në profesionist të kualifikuar të fushës së arkitekturës, më konkretisht në dy profile të ofruara: Arkitekturë interieri dhe Urbanistikë.</p> <p>Kurrikula e programit saktëson të gjitha lëndët e grupuara si më lartë dhe është ofruar në <i>ankesin/shtojcën 14</i>.</p>

<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Praktika profesionale (lënda: Praktikë profesionale dhe zhvillim karriere) dhe detyrimet përmbyllëse të studimeve në të cilat hyn edhe Punimi i Diplomës, në kuadër të Programit të integruar në Arkitekturë, në kurrikulë kanë të përcaktuara ECTS kredite. Praktika profesionale dhe zhvillimi i karrieres me 9 ECTS, derisa Punimi i Diplomës me 15 ECTS kredi.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Nuk aplikohet në rastin e Programit në proces të akreditimit!</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Nuk aplikohet në rastin e Programit në proces të akreditimit!</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në</p>	<p>Forma e organizimit të studimeve në IAL, si dhe pranimi i studentëve mbështetet me dokumentet dhe legjislacionin në fuqi. Dokumenti mbi politikat e pranimi të studentëve (<i>shih aneksin 27.1</i>) tregon procedurat dhe kriteret e pranimi. Gjatë vizitës në lokacion është diskutuar rreth hapave të pranimi të studentëve të rinj, me ç’rast është përmendur Parakontrata (një shembull</p>



përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	është kërkuar GVJ, si dokument shtesë, aneksi 4, akt marrëveshjeje)			
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Në lidhje me këtë kriter IAL bazohet në vendimet e bashkëlidhura si anekse, vendimin për elementet e programeve të studimit, si dhe ato të kodifikimit të programeve. Është vendimi me Nr.41 i dates 24.01.2018 në të cilin saktësohen programet e studimit të ciklit të dytë si: Master i shkencave/master i arteve, si dhe Master ekzekutiv. Megjithatë në IAL nuk ofrohet ndonjë program tjetër I ciklit të dytë në të njëjtën fushë të studimit. (shih anekset: 53.1 dhe 53.3)			
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Bazuar në shkresën dërguar Ministrisë së Arsimit me datë 31/03/2023, vërehet reagimi/veprimi i UET në raport me kërkesën për kodifikim dhe klasifikim të programeve të cilat ofrohen në institucion dhe të cilat janë sipas direktivave kombëtare dhe ndërkombëtare. Mbi bazën e vendimit Nr.41 të dates 24.01.2018 është bërë implementimi i kodifikimit dhe shtrirjes së kurrikulës së ciklit të dytë në fushë përkatëse të studimit, e cila përmbanë komponenten mësimore në lëndë bazë, karakterizuese dhe ndërdisiplinore/integruese (shih aneksin 53.1)			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi në akreditim nuk është program i përbashkët me ndonjë nga institucionet tjera të arsimit të lartë.			
Konkluzione	<i>Themelimi i Programit të studimit, licencimi si dhe hapat tjerë të funksionimit, janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore si dhe të njëjtat mbështeten edhe me strukturën e brendshme ligjore dhe rregulluese të IAL.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Universiteti European i Tiranës në kuadër të organigramës së njësive të veta akademike ka Fakultetet dhe Departamentet, në rastin konkret Programi i integruar në Arkitekturë, zhvillohet në kuadër të Departamentit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës si njësi e Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, e gjitha në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin e njësive akademike dhe kushteve të akreditimit. Sa i përket stafit akademik, dokumentacioni i ofruar në trajtë të tabelave përmbledhëse (<i>shih aneksin 0.2</i>) tregon numrin dhe kualifikimet e stafit akademik të angazhuar dhe në raport me kërkesat e akreditimit dhe vlerësimin të Programit studimor përkatës: PAE - (2) Prof. Dr. (2) Prof. Asoc. Dr. (4) Dr. (0) Dr.proc. (5) MSc, si dhe PAK - (3) Prof. Dr. (1) Prof. Asoc. Dr. (4) Dr. (0) Dr.proc. (12) MSc. Me shumicën prej tyre është komunikuar gjatë vizitës së GVJ në lokacion.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Në kuadër të njësisë bazë dhe Departamentit, realizimi i Programit në akreditim mundësohet me angazhimin e stafit përkatës akademik si dhe atij administrativ.</p> <p><i>Megjithatë kur flitet për stafin akademik, është e dëshirueshme që të shikohet mundësia e angazhimit të një numri më të madh të mësimitdhënësve të fushës së arkitekturës dhe urbanistikës, në raport me mësimitdhënësit e fushave tjera mbështetëse për realizim dhe mbarëvajtjes së programit.</i></p> <p>(shih Departamentin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës në linkun në vijim: https://uet.edu.al/fakulteti-i-inxhinierise-informatikes-e-arkitekture/)</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe</p>	<p>Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës si njësi kryesore bazë ka Departamentin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës, në krye të të cilit është caktuar personi përgjegjës / udhëheqësi / koordinatori, i cili kujdeset për mbarëvajtjen e Programit të integruar në Arkitekturës.</p> <p>https://uet.edu.al/perjegjesisit-e-departamenteve/</p> <p>(shih aneksin: 36 për përcaktimin e koordinatorëve)</p>

zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.				
Konkluzione	<i>Struktura bazë organizative për Programin e studimit në akreditim funksionon në bazë të organigramës së përcaktuar nga IAL, është e qasshme dhe vepron në drejtim të sigurimit të përgjithshëm të cilësisë. Kjo është konfirmuar gjatë vizitës së GVJ në Institucion.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin në dispozicion si dhe gjatë takimit me personat përgjegjës, njësia kryesore e cila është përgjegjëse për programin në akreditim, ka informacione lidhur me të gjitha komponentat e mbarëvajtjes së programit (organizimi, struktura si dhe përmbajtja). Po ashtu, GVJ gjatë vizitës në lokacion dhe gjatë bisedës me Përgjegjësen e Departamentit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës/ Koordinatorin e Programit të studimit është informuar në lidhje me mënyrën e komunikimit me studentet si dhe ofrimin e informacioneve të përgjithshme lidhur me studimet, derisa prezentimi i syllabus-eve në fillim të semestrit bëhet nga ana e secilit mësimdhënës përgjegjës për lëndën përkatëse, përfshirë vendosjen në platformën e brendshme elektronike. Informacionet rreth programit të integruar mund të qasen edhe në webfaqe si në vijim: https://uet.edu.al/programe-te-integruara/
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën	Programi i integruar në Arkitekturë ka planin mësimor i cili është i përbërë nga lëndët e grupuara si vijon: lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinare si dhe lëndë plotësuese. Ndarja në semestra dhe ngarkesat janë të paraqitura në

mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	dokumentacionin e dorëzuar, më konkretisht në <i>(anekset: 14, 14.2 dhe 14.4)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Takimi me stafin përgjegjës në zyret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve (shërbimit të studentëve) në nivel të IAL, si dhe dokumentacioni i bashkëlidhur, plotësojnë kërkesën e programit për këto specifika <i>(anekset 27.1 dhe 28)</i> . Gjatë takimit është diskutuar çështja e pranimit si dhe parakontratës së ofruar nga IAL për kandidatët e interesuar, derisa një shembull është kërkuar si dokument shtesë.
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Materiali i bashkëlidhur tregon respektimin e formatit të Syllabus-eve me përmbajtjen e duhur për lëndët të cilat ofrohen në kuadër të Programit të studimit. Zbërthimi tabelar i lëndëve në grup lëndësh sipas specializimeve, disiplinave si dhe lëndëve bazë, është prezantuar në kuadër të materialit të bashkëlidhur në formë aneksi. Si shembull i analizës është marrë Syllabus-i i lëndës Projektim urbanistik i cili ka shtrirjen në bazë të vendimit të lëshuar nga Minsitria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me Nr.41 të datës 24.01.2018 (ndryshuar me VKM nr. 879, date 19.12.2019), shtojca nr.3 – programi i lëndës në faqet 9-10. Gjatë vizitës në lokacion është theksuar kontrolli i vazhdueshëm i cilësisë së Syllabus-eve para secilit vit akademik.
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Përmbajtja e programit është në nivel të kënaqshëm, derisa përmirësimi apo përditësimi që prej fillimit të ofrimit, nuk vërehet në veçanti. Duhet të theksohet se një numër simbolik lëndësh kanë pësuar ndryshime prej njëjës gjeneratë të studimit në tjetrën, gjë që është konfirmuar në takim me studentët. Marrë parasysh faktin se programi në fjalë aplikon për akreditim për herë të parë, ndryshime të theksuara nuk vërehen, derisa (siç përmendet më sipër në bisedë me student) ndryshime janë vërejtur të ofrimi i lëndëve ndërdisiplinore/ integruese.
Konkluzione	<i>Programi i studimit me strukturën aktuale të cilën e ka, të ndarë në lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore si dhe lëndë plotësuese, mund të konsiderohet i organizuar konform parashikimeve dhe objektivave të studimeve master apo të ciklit të dytë.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Përmbajtja e Programit të studimit me specializime të cilat ofrohen, përmban lëndë apo grup lëndësh të cilat janë në përputhje me ushtrimin e profesionit si dhe shërben si bazë për studimet e mëtejshme. Megjithatë, ekziston mundësia e plotësimin të lëndëve specifike për secilin specializim të cilat definojnë qartë të njëjtin (në grupin e lëndëve ndërdisiplinare/integruese), mund të shihet në (aneksin 14)
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Programi është formësuar në atë mënyrë që mundëson arritjen e objektivave formues të programit, përfshirë rezultatet e të nxënit, gjithnjë duke e parë mundësinë e plotësimin si në kriterin 1. Programi i studimit organizohet në 5 vite të studimit me 300 ECTS kredi, derisa rezultatet e të nxënit apo pritshmëritë përcaktohen në kuadër të programit në tërësi dhe programet e lëndëve në veçanti, dhe atë në bazë të: përmbledhjes dhe rezultateve të të nxënit, formave të kontrollit të dijeve, kontrollit të vazhdueshëm, për të përfunduar me vërejtjet përfundimtare të pedagogut përgjegjës të lëndës.
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi,	Ky kriter në përgjithësi plotësohet me strukturën ekzistuese të programit, por në aspektin historik dhe teorik struktura e programit të studimit duhet të plotësohet me interpretimin e stileve të arkitekturës së Shek.20 më saktësisht Arkitekturën moderne dhe atë bashkëkohore, gjë e cila nuk vërehet në program dhe e cila është konfirmuar gjatë bisedave të zhvilluara në lokacion. <i>Gjithashtu GVJ, referuar eksperiencave më të mira të shkollave evropiane, vlerëson se ngarkesa javore në auditor për lëndët studio arkitekture duhet të jetë më e lartë sesa ajo aktuale.</i>

kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Me strukturën ekzistuese të programit të studimit një gjë e tillë është e mundur, duke marr parasysh përditësimin e vazhdueshëm të programit me përmbajtje të cilat shkojnë konform zhvillimit të programeve studimore europiane si dhe kërkesave të vazhdueshme të tregut të punës në këtë fushë.
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Nuk është vërejtur ndonjë veçanti në ndryshim apo përditësim të Syllabuseve, derisa literatura bazë dhe ajo ndihmëse janë në disa raste edhe mbi 10 vite të vjetra (përfshirë lëndët si Bazat e Projektimit). Si argument, shih anekset e bashkëlidhura të Syllabuseve në fjalë (anekset 19).
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Me strukturën ekzistuese të programit të studimit një gjë e tillë është e mundur, duke marr parasysh përditësimin e vazhdueshëm të programit me përmbajtje të cilat shkojnë konform zhvillimit të programeve studimore të cilat edhe më shumë mundësojnë arritjen e synimeve të programeve në fushën e arkitekturës dhe urbanistikës.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Me strukturën ekzistuese të programit të studimit një gjë e tillë është e mundur, duke marr parasysh përditësimin e vazhdueshëm të programit me përmbajtje të cilat shkojnë konform zhvillimit të programeve studimore europiane si dhe kërkesave të vazhdueshme të tregut të punës në këtë fushë.
Konkluzione	<i>Janë disa çështje të cilat do të duhej të adresohen në të ardhmen, siç është rasti i mospërfshirjes së lëndës e cila bënë interpretimin e arkitekturës moderne, stileve të Shek.20, si dhe arkitekturës bashkëkohore në kuadër të Kurrikulës. Ngarkesa javore në orë</i>

	<p>për Studiote e Arkitekturës vlerësohet e ulët. Po ashtu, duhet të shikohet mundësia e plotësimit të lëndëve specifike për secilin specializim të cilat definojnë qartë të njëjtin (në grupin e lëndëve ndërdisiplinare/ integruese). Megjithatë, struktura e programit mund të konsiderohet konform nivelit të kërkuar të kualifikimit dhe nevojave të tregut.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Në anekset e prezantuara (12.1, 12.2, 12.5, 13 dhe 17) shihen dokumentet të cilat tregojnë rregulloret si dhe kontaktet me palët e treta të cilat mund të konsiderohen si tendencë për marrjen e informatave dhe mundësisë së përmirësimit apo plotësimit të përmbajtjes së programit të studimit nga IAL.</p> <p>Takimet me Bordin e tregut të punës siç është prezentuar në minutat nga njëri prej tyre (ankesi 12.2) tregojnë qëllimin e marrjes së mendimeve lidhur me reorganizimin e studimeve bachelor në arkitekturë dhe inxhinieri.</p> <p>Aneksi 17 në veçanti tregon studimin e tregut të punës nga IAL me qëllim të reformimit të programeve të studimit të cialt ofrohen në institucion.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në</p>	<p>Ne ankesin 38.1 mund të shihet përfshirja dhe mendimi i studentëve në procesin mësimor dhe mbarëvajtjen e të njëjtit. Gjatë takimit me studentët është argumentuar ky komunikim me qëllim të reflektimit të institucionit në përmirësimin dhe plotësimin e programit të studimit.</p>

ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.									
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	<p>Në anekset e prezantuara (12.1, 12.2, 12.5, 13 dhe 17) shihen dokumentet të cilat tregojnë rregulloret si dhe kontaktet me palët e treta të cilat mund të konsiderohen si tendencë për marrjen e informatave dhe mundësisë së përmirësimit apo plotësimit të përmbajtjes së programit të studimit nga IAL.</p> <p>Takimet me Bordin e tregut të punës siç është prezentuar në minutat nga njëri prej tyre (ankesi 12.2) tregojnë qëllimin e marrjes së mendimeve lidhur me reorganizimin e studimeve bachelor ne arkitekturë dhe inxhinieri.</p> <p>Aneksi 17 në veçanti tregon studimin e tregut të punës nga IAL me qëllim të reformimit të programeve të studimit të cilat ofrohen në institucion.</p> <p>Si në Kriterin 1. të këtij standardi dhënë më sipër, ky kriter mbështetet me plotësimin i cili ka të bëjë me marrëveshjet të cilat institucioni ka me profesionist (anekset 34.1-34.16) mbi bazën e të cilave synon përditësimin dhe përshtatjen e programit të studimit me zhvillimet e fundit.</p>								
Konkluzione	<i>Dokumentet e prezantuara dhe takimet në lokacion, tregojnë gatishmërinë e IAL për përfshirjen e studentëve në njërin dhe palëve të treta (partneriteteve profesionale dhe institucionale) në anën tjetër, në procesin e përmirësimit dhe plotësimit të anës programore.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në	Në kuadër të Rregullores mësimore (ankesi 7) është i përfshirë përcaktimi i prioriteteve dhe objektivave kryesore si në këtë kriter. Më saktësisht në pikën 3.1.4 (Pjesë e veprimtarive mësimore në fushën përkatëse është edhe puna kërkimore. Gjatë vitit të parë të studimeve studenti ndjek lëndët Shkrim Akademik

përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	dhe Metodatat e kërkimit, dhe aftësohet për të shtruar një tezë dhe për ta mbrojtur atë në formë analitike, duke u bazuar kryesisht në literaturën teorike. Këto aftësi studenti i zhvillon përgjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve, nëpërmjet përgatitjes së detyrave të kursit dhe detyrave praktike brenda secilës lëndë të programit. Studentët mbrojnë diplomën me punim diplome.), si dhe 3.3 të rregullores në fjalë (Objektivat e Programit të Studimit).				
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Personeli akademik përveç mësimdhënies është i përfshirë në aktivitetet kërkimore dhe projekte të cilat mund të vërehet në anekset e bashkëlidhura (43 dhe 43.1). Gjatë vizitës së ekspertëve në lokacion është diskutuar për këtë, derisa janë përmendur edhe projekte në të cilat janë përfshirë edhe studentët, duke bashkërenduar në këtë mënyrë procesin mësimor dhe atë kërkimor.				
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	(Si në Kriterin më sipër) Gjatë vizitës së ekspertëve në lokacion është diskutuar për këtë, derisa janë përmendur edhe projekte në të cilat janë përfshirë edhe studentët, duke bashkërenduar në këtë mënyrë procesin mësimor dhe atë kërkimor. Në këtë kontekst përmendet dhe shihet në <i>aneksin 55</i> . aktiviteti i cili ka këtë synim.				
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	IAL nëpërmes Strategjisë së kërkimit shkencor 2021-2025, prezanton mbështetjen nga ana e institucionit në drejtim të njëjësive bazë në kuadër të të cilave zhvillohen Programet e caktuara studimore dhe aktivitetet e tyre, e në rastin konkret Programi studimor i integruar në Arkitekturë.				
Konkluzione	<i>Nëpërmes Strategjisë për kërkimin shkencor dhe dokumenteve tjera të cilat mbështesin këtë fushë, IAL mundëson orientimin dhe përkushtimin e stafit akademik drejtë projekteve dhe avancimit shkencor, përfshirë këtu projektet dhe aktivitetet shkencore në të cilat përfshihen edhe studentët.</i>				
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

				X
--	--	--	--	---

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	<i>Aneksat 43 dhe 43.1</i> tregojnë aktivitetin kërkimor dhe pjesëmarrjen e stafit akademik në projekte të sponsorizuara nga strukturat europiane si ERASMUS+ e të tjera. Kjo tregon tendencën për mbështetje të ofruar në këtë drejtim. Ky fakt mund të mbështetet me diskutime të realizuara në kuadër të vizitës së ekspertëve në lokacion dhe ato me zyret përkatëse.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Gjatë vizitës së ekspertëve në lokacion është vërejtur mbështetja e zyrës përkatëse për projekte në drejtim të kërkesave për angazhim të stafit akademik dhe studentëve, mbi të gjitha për përmbushjen e objektivave kërkimore dhe shkencore të programit të studimit.
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	IAL me përfshirjen e Njesisë bazë në kuadër të të cilës zhvillohet programi studimor, organizon konferencën vjetore – Ditët e studimeve shqiptare (aneksi 55), e cila ka për qëllim përfshirjen e stafit dhe studentëve në këtë aktivitet me tendencë për të ju ndihmuar në arritjen e objektivave të studimeve dhe programit.
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues	Bazuar në aneksin mbi Monitorimin e ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre, programi i studimit tenton të argumentoj formimin e profesionistëve konkurrues në tregun e punës, pas përfundimit të studimeve në fushën e arkitekturës dhe urbanistikës (<i>Shih aneksin 29</i>). I njëjti përmban komponentat siç


për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	janë: Sistemi i regjistrimit dhe ruajtjes së statistikave për studentët në UET, si dhe Kuadri ligjor i punësimit në fushën e programit të studimit. Po ashtu theksohet se të diplomuarit, në mënyrë që të e ushtrojnë profesionin, kanë për obligim të regjistrohen në regjistrat profesional të subjekteve të licencuara në fusha përkatëse, bazuar në rregulloren e VKM me Nr. 759 të dates 12.11.2014, të ndryshuar.			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Aneksi si në kriterin më sipër (aneksi 29), në kuadër të pikës B - Kuadri ligjor i punësimit në fushën e programit të studimit, nënvizon kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës së arkitekturës dhe urbanistikës. Po ashtu, në të njëjtë pike saktësohen mundësitë e veprimtarive të punësimit sipas kompetencave në: Studio profesionale, kompani ndërtimi, administratë publike, agjenci të ndryshme shtetërore, institucione të tjera shtetërore apo private, si dhe si profesionist të lirë, gjithnjë në fushën përkatëse të arkitekturës dhe urbanistikës.			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Ky kriter konsiderohet duke u bazuar në faktin se studimet në kuadër të programit në akreditim zgjasin 5 vite (si profesion i rregulluar, si në vend ashtu edhe në Europë), poashtu edhe bazuar në aspektin përmbajtësor të programit të studimeve në arkitekturë dhe urbanistikë, me mundësi të përditësimeve në vazhdimësi.			
Konkluzione	<i>Programi i studimit ka përmabjtje të atillë e cila studentëve ju mundëson arritjen e njohurive dhe profesionalizmin në fushën e arkitekturës, me mundësi të njohjes dhe veprimit edhe në rrafshin ndërkombëtar, përfshirë këtu edhe kërkimin shkencor dhe të arriturat në këtë drejtim.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Planprogrami i prezantuar në trajtë tabelare, tregon shtrirjen e të gjitha formave të aplikuara të mësimdhënies dhe mësimnxënies, të cilat përfshijnë leksionet, punën në laborator, punën në studio, etj. Të gjitha këto hollësira janë diskutuar dhe konfirmuar edhe gjatë vizitës në Institucion, si me mësimdhënësit ashtu edhe me studentët.
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Në kuadër të Syllabus-eve, sikur në rastin e lëndës së Studios në Arkitekturë, specifikohet metoda pedagogjike e cila aplikohet për secilën prej temave të cilat shtjellohen. Këto metoda përfshijnë forma të ndryshme të komunikimit dhe transmetimit të njohurive nga mësimdhënësi, si me grup studentësh ashtu edhe konsulta individuale, gjë e cila konsiderohet si metodologji e pranueshme për studimet në fushën e arkitekturës dhe urbanistikës.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Institucioni në këtë drejtim prezanton trajnime profesionale të stafit akademik si në aneksin 33, gjë që mbështetë aktivitetin për përmirësimin e kompetencave didaktike. Ky proces njëkohësisht mund të mbështetet edhe nga zyra për sigurimin e cilësisë.

<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Përveç Syllabus-ëve të cilët janë përpiluar me qëllim të theksimit dhe përfshirjes së të gjitha specifikave dhe formave të mësimdhënies dhe mësimnxënies, takimi i zhvilluar me mësimdhënësit dhe studentët tregon gatishmërinë për komunikim të duhur dhe të ndërsjellë, dhe atë me aplikimin e metodologjive të kohës të cilat përfshijnë interaktivitetin, diskutimet dhe mendimet kritike rreth problematikave të cilat shtjellohen në proces mësimor.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Studentët janë të përfshirë në procesin e vlerësimit të mësimdhënësve dhe mësimdhënies, nëpërmes pyetësorëve online (aneksi 40.1) si dhe nëpërmes takimeve të cilat zhvillohen me ta në nivel departamenti, siç mund të shihet në aneksin 38.1. Gjatë takimit me studentët është theksuar kjo mundësi e cila ju jepet në periudha të caktuara gjatë vitit akademik.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të</p>	<p>Në kuadër të IAL funksionon Zyra për sigurimin e brendshëm të cilësisë e cila ka për obligim monitorimin dhe mbështetjen në përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të mësimdhënies. Aktivitet e kësaj zyreje, kompetencat dhe obligimet janë të përcaktuara në kuadër të manualit për sigurimin e cilësisë (aneksi 30.2), strategjinë për sigurimin e cilësisë (aneksi 30.3), si dhe metodologjinë e punës (aneksi 30.5), derisa veprimtaria/fushëveprimi në këtë drejtim evidentohet në anekset 30.6-30.12. Të gjitha këto aktivitete organizohen dhe monitorohen me qëllim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe përditësimin e vazhdueshëm e metodologjisë.</p>



reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.									
Konkluzione	<i>Sigurimi i brendshëm i cilësisë mbështetur me Strategjitë e hartuara si dhe Rregulloret relevante në këtë fushë, mundësojnë një proces të qartë të vlerësimit dhe arritjes së rezultateve nga ana e studentëve, duke konfirmuar në këtë mënyrë rëndësinë e tyre në këtë drejtim.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregullorja mësimore e Programit të integruar të studimeve në Arkitekturë (aneksi 7) saktëson mënyrën e vlerësimit të studentëve, dhe atë në kuadër të pikës 5 (kontrolli i dijeve të fituara nga studentët), duke përfshirë sistemin e vlerësimit, mënyrën e kontrollit të dijës sipas tipologjive të lëndëve, provimet, riprovimet, etj.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e	Formati dhe përmbajtja e Syllabus-eve tregon metodologjinë e vlerësimit të njohurive sipas specifikave të lëndëve, si dhe karakteristikat e tjera lidhur me këtë. Takimi me mësimdhënësit konfirmon prezantimit e të njejtëve në fillim të semestrit për secilën lëndë në veçanti.

lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.									
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Vlerësimet janë të përcaktuara në formatin e Syllabus-it në përgjithësi, si dhe për lëndë në veçanti, në pjesën e cila adreson Formën e kontrollit të dijeve (anekset 19...). Vërehen dallime në përqindje të vlerësimit konform specifikave të lëndëve.								
Konkluzione	<i>Syllabus-et e lëndëve janë të ndërtuara në atë mënyrë që tregojnë qartë formën e vlerësimit të studentëve, dhe atë në pjesën e cila adreson Formën e kontrollit të dijeve, po ashtu mbështetur me Rregulloren mësimore të Programit të studimit.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive dhe dijes, bëhet konform Syllabus-it të përcaktuar të lëndës, me ç'rast 100%-shi i vlerësimit distribuohet nëpër vlerësime periodike dhe nëpërmes detyrave të caktuara dhe specifike për lëndët, përfshirë provimin përfundimtar. Shih Syllabus-et e lëndëve me këto specifika në <i>anekset 19</i> . Sistemi i vlerësimit të studentëve në <i>aneksin 7.2</i> , po ashtu mbështetë të mësipërmen.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të	Gjatë vizitës në lokacion dhe gjatë takimit me Udhëheqësit e Departamentit, përfshirë edhe takimin me mësimdhënës është theksuar testimi i metodologjisë elektronike 'clean scoring'.

ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive dhe dijes, bëhet konform Syllabus-it të përcaktuar të lëndës, me ç’rast 100%-shi i vlerësimit distribuohet nëpër vlerësime periodike dhe nëpërmes detyrave të caktuara dhe specifike për lëndët, përfshirë provimin përfundimtar. Shih Syllabus-et e lëndëve me këto specifika në <i>anekset 19</i></p> <p>Sistemi i vlerësimit të studentëve në aneksin 7.2, po ashtu mbështetë të mësipërmen, duke shtuar edhe përputhshmërinë me Rregulloren mësimore (<i>aneksi 7</i>), më saktësisht pikën 5 të kësaj rregulloreje. Mbi bazën e kësaj, Kontrolli i brendshëm i cilësisë prodhon raportin për kontrollën e provimeve (<i>aneksi 30.6</i>).</p>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	<p>Rregullorja mësimore (<i>aneksi 7</i>) në kuadër të pikës 5.3 saktëson tërë procesin e provimit, përfshirë këtu kohën brenda së cilës mësimdhënësi ofron mundësi të sqarimit të vlerësimit, derisa në pikën 5.8 tregohet mundësia dhe procesi i rivlerësimit, si dhe mundësia e ankimimit.</p> <p>Pika 5.3 saktëson vlerësimin në provime të ndërmjetme dhe ato përfundimtare, procedurat e mbajtjes së tyre vlerësimin me pikë, dorëzimin e vlerësimeve brenda afatit të caktuar, të drejtat e studentit për të iu nënshtruar provimit përfundimtar, si dhe mosparaqitjen dhe humbjen e të drejtës së hyrjes në provim përfundimtar të një lënde.</p>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	<p>Janë dokumentet e caktuara si Strategjia e sigurimit të cilësisë (<i>aneksi 30.3, pika 4</i>), Kodi i etikës (<i>aneksi 56, pikat: A.II.10, A.I.5.2, A.I.5.7, dhe A.II.7.2</i>) në të cilat mbështeten mësimdhënësit dhe stafi përgjegjës me qëllim të shmangies së plagjiaturës dhe kopjimit në të gjitha fushat relevante. Në këtë kontekst hyn edhe implementimi i programit antiplagjiaturë Turnitin.</p>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	<p>Rregullorja mësimore (<i>aneksi 7</i>) në kuadër të pikës 5.3 saktëson tërë procesin e provimit, përfshirë këtu kohën brenda së cilës mësimdhënësi ofron mundësi të sqarimit të vlerësimit, derisa në pikën 5.8 tregohet mundësia dhe procesi i rivlerësimit, si dhe mundësia e ankimimit.</p>

	<p>Pika 5.3 saktëson vlerësimin në provime të ndërmjetme dhe ato përfundimtare, procedurat e mbajtjes së tyre vlerësimin me pikë, dorëzimin e vlerësimeve brenda afatit të caktuar, të drejtat e studentit për të iu nënshtruar provimit përfundimtar, si dhe mosparaqitjen dhe humbjen e të drejtës së hyrjes në provim përfundimtar të një lënde.</p> <p>Në kuadër të rregullores mësimore në përgjithësi përcaktohen hapat e duhur të cilat duhet të ndiqn si dhe afatet kohore.</p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Kërkesa për rishikim të vlerësimit garantohej me dokumentet relevante në fuqi të cilat implementon Institucioni dhe Njësia bazë, përfshirë këtu Statutin e IAL (aneksi 2), Rregulloren e IAL (aneksi 5), si dhe Rregulloren mësimore të Programit të integruar Master në Arkitekturë (aneksi 7). Të gjitha këto dokumentet në kuadër të pikave dhe neneve përkatëse sigurojnë dhënien e mundësisë për studentët lidhur me vlerësimin dhe kërkesën për rivlerësim.</p>			
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Rregullorja mësimore e Programit të studimit (aneksi 7) në pikën 5.8, nën-pikat 5.8.1 dhe 5.8.2 saktëson procedurat në rast të ankimit, formimin e komisioneve dhe trajtimin të të njejtës. Më konkretisht, pas konsumimit të procedurave të sqarimit me mësimdhënësin e lëndës, studenti mund të i drejtohet me shkrim Drejtuesit të Departamentit me ankesë të bazuar, me ç'rast mund të krijohet komisioni prej tre mësimdhënësve I cili e shqyrton të njejtën dhe bënë rivlerësimin.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Rregullorja mësimore e Programit të studimit dhe implementimi i saj në këtë drejtim, gjë që është diskutuar gjatë vizitës në Institucion, tregon formën e vlerësimit dhe mundësinë e cila i jepet studentit në rast të pakënaqësisë me vlerësim dhe trajtim të ankimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Bazuar në Kurrikulën e Programit të studimit (<i>aneksi 14</i>) dhe mbështetur me Rregulloren mësimore (<i>aneksi 7</i>) pikën 3.3, tregohen objektivat e programit të studimit të cilat saktësojnë implementimin e këtij kriteri. Më saktësisht objektivat kanë të bëjnë me skatësimin e synimeve të programit të studimeve Master shkencor (me nënpikat), si dhe me saktësimin e Rezultateve të të nxëniet në përfundim të programit të studimit dhe aftësitë e arritura.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Me grupimin e lëndëve në: lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinare si dhe lëndë plotësuese në kuadër të Kurrikulës dhe planit mësimor (<i>aneksi 14.4</i>), Programi i studimit në akreditim, synon zhvillimin e aftësive të kërkuara në këtë kriter. Kësaj duhet të i shtohen edhe trajnimet profesionale (<i>aneksi 33.1</i>) të cilat ofrohen nga Njësia bazë dhe Departamenti.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Takimi me mësimdhënësit ka treguar dhe saktësuar procesin e përmbushjes së Syllabus-ëve, në kuadër të të cilëve përfshihen kompetencat dhe aftësitë të cilat studentët do të kenë në përfundim të lëndës, përfshirë këtu rezultatet e të nxëniet (<i>anekset 19...</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe</p>	<p>Metodologjia e cila aplikohet bazohet në karakteristikat e secilës lëndë, si dhe fushëveprimin që mbulon. Takimet e veçanta me mësimdhënësit dhe studentët kanë treguar gatishmërinë për implementimin e metodologjisë interaktive të mësimdhënies dhe formave tjera inovative të komunikimit në këtë process. Kjo tregon po ashtu mundësinë e përfshirjes së studentëve në mobilitete dhe përshtatjen e tyre në kushte studimit në nivel ndërkombëtar.</p>

<p>zgjdhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundur dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>				
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Me ofrimin e trajnimeve profesionale në fushat aktuale si eficientia e energjisë, auditimi si dhe vlerësimi i pasurive të paluajtshme, tregon gatishmërinë që të zgjerohen njohuritë edhe jashtë Kurrikulës apo planit mësimor të cilin ofron Programi në akreditim.</p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>IAL ka hartuar Strategjinë e Kërkimit shkencor 2021-2025 (aneksi 3.1) e cila mbulon kërkesat e këtij kriteri. Të njëjta mbështeten me pikën 13, e cila mbështetë Kërkimin, zhvillimin dhe transferimin e teknologjisë, si dhe me pikën 14 e cila mbulon Burimet dhe mënyrën e financimit, përfshirë këtu vënien në dispozicion të një fondi kërkimor i cili synon mbështetjen financiare projektet kërkimore dhe publikimet.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në objektivat e programit të studimit të cilat saktësohen në Rregulloren mësimore të Programit të studimit në akreditim, tregohet gatishmëria për garantimin e aftësive dhe rezultateve të pritura të të nxënit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Detyrimet përmbyllëse të studentit lidhen me procesin e përfundimit të diplomës. Në këtë kontekst, Dokumenti mbi punimin e diplomës/dizertacionit saktëson të gjithë hapat lidhur me procedurat përmbyllëse (aneksi 10).
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Në po të njëjtin Dokument si më sipër, në kuadër të pikes B.II.5 lidhur me Seancat metodologjike, saktësohen të gjithë hapat të cilët duhet të ndiqen, përfshirë asistencën e ofruar nga Udhëheqësit (nga radhët e personelit akademik), dhe ate në funksion të përfundimit të suksesshëm të detyrimeve përmbyllëse të studentit.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Përmbyllja e studimeve në Programin e integruar Master në Arkitekturë, karakterizohet vetëm me mbrojtjen e punimit të diplomës, konform rregulloreve në fuqi në kuadër të IAL dhe Njësisë bazë.
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai	Dokumenti mbi punimin e diplomës/dizertacionit saktëson të gjithë hapat lidhur me procedurat përmbyllëse (aneksi 10), derisa në kuadër të pikes B.II.5 lidhur me Seancat metodologjike, saktësohen të gjithë hapat të cilët duhet të ndiqen, përfshirë asistencën e ofruar nga Udhëheqësit (nga radhët e personelit akademik), dhe ate në funksion të përfundimit të suksesshëm të detyrimeve përmbyllëse të studentit dhe mbrojtjes para komisionit të caktuar.

garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Bazuar në natyrën e hulumtimit, teorike apo praktike/në terren, IAL mund të ofroj ndihmën në lidhje me literaturën në bibliotekë fizike apo elektronike, punën në hapësirat që ka në dispozicion, si dhe lëshimin e dokumentacionit i cili mbështetë studentin për punën në terren.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Dokumenti mbi punimin e diplomës në pikën e cila i referohet procedurës së mbrojtjes (B.II.13.4), përfshinë edhe shpjegimin e vlerësimit me notë të punimit të diplomës nga ana e Komisionit vlerësues.
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Aneksi 15.2 tregon modelin e diplomës së lëshuar nga IAL, përfshirë suplementin. Në RVB theksohet se si shtesë, studenti ka të drejtë të kërkoj planin mësimor dhe Syllabus-et në rast.
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Bazuar në RVB theksohet se institucioni mban dosjen e studentit të diplomuar për statistikat të cilat lidhen me prezantimin e të dhënave para institucioneve relevante të lidhura me licencimin apo akreditimin e programeve studimore dhe atij institucional.
Konkluzione	<i>IAL nëpërmes Dokumenteve dhe Rregulloreve relevante, saktëson procedurat e duhura të cilat mundësojnë përfundimin e suksesshëm të detyrimeve përmbyllëse të studimeve, përfshirë kompletimin e dokumentacionit të secilit student.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Ky kriter dhe standard nuk aplikohet në rastin e Programit të interguar të studimit Master në Arkitekturë i cili është në proces akreditimi, pasi që nuk kemi të bëjmë me Program ‘Master profesional’.
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Ky kriter dhe standard nuk aplikohet në rastin e Programit të interguar të studimit Master në Arkitekturë i cili është në proces akreditimi, pasi që nuk kemi të bëjmë me Program ‘Master profesional’.
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e	Ky kriter dhe standard nuk aplikohet në rastin e Programit të interguar të studimit Master në Arkitekturë i cili është në proces akreditimi, pasi që nuk kemi të bëjmë me Program ‘Master profesional’.

trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.				
Konkluzione	<i>Standardi nuk aplikohet në rastin e Programit të interguar të studimit Master në Arkitekturë i cili është në proces akreditimi, pasi që nuk kemi të bëjmë me Program 'Master profesional'.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
	-	-	-	-

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e	Nga verifikimet e kryera gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe vizitës në UET u konstatua se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit ka përgjithësisht përputhshmëri me kërkesat ligjore. U konstatuan raste kur në vitin e katërt dhe të pestë lëndët mbulohen nga personel akademik me kualifikimin të ciklit të dytë (MSc), konkretisht E.M., A.Dh., G.H., E.P. (0.2 – Tabela 4). GVJ rekomandon zgjidhjen e këtij problemi, duke garantuar për lëndët që zhvillohen në vitin e katërt dhe të pestë të programit të studimit angazhimin e personelit akademik me kualifikimin minimal të ciklit të tretë të studimeve. <i>Gjithashtu, vërehet që numri i personelit akademik me kohë të plotë me kualifikim në fushën e arkitekturës dhe urbanistikës është i vogël, 6/18 PAE për vitin akademik 2022-2023 (0.2 – Tabela 4).</i>

studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Më hollësisht stafi i programit të studimit për periudhën 2018 – 2023 dhe kualifikimi i tyre paraqiten në tabelat 6.1-6.5, 7 dhe 8, si më poshtë vijon:

Tituj/ grada	2018- 2019		2019- 2020		2020- 2021		2021- 2022		2022- 2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	-	3	-	2	-	2	-	2	1
Prof. Asoc.	1	-	2	1	1	1	1	1	2	2
Dr./PhD.	4	1	3	1	6	3	7	3	7	3
Msc.	3	1	5	1	8	2	8	4	9	7
Totali	9	2	13	3	17	6	18	8	20	13

Nga sa më sipër rezulton se në procesin e mësimdhënies të programit të studimit të ciklit të dytë Msc në Arkitekturë, janë angazhuar edhe staf akademik me Msc, në ndryshim nga parashikim i nenit 59/6 të Ligjit nr. 80/2015 ku përcaktohet: *“Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës”*.


- Në vitin akademik 2021 -2022, rreth 46 % e stafit mësimdhënës janë me MSc;
- Në vitin akademik 2022 -2023, rreth 48 % e stafit mësimdhënës janë me MSc;

GVJ rekomandon të meren masat e nevojshme për të mundësuar që personeli akademik efektiv dhe me kontratë i angazhuar në realizimin e programit të studimit të ketë të paktën gradën shkencore Dr., në mënyrë që të përmbushen kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik.

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Ngarkesa e PAE anëtarë të Departamentit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës varion nga 180 në 390 orë për vitin akademik 2022-2023, ngarkesë kjo që konsiderohet nga GVJ e përballueshme dhe pa efekte në cilësinë e mësimdhënies (**0.2 – Tabela 4**).

	<p>Nga të dhënat e ofruara në Tablën 12.1-12.5, rezulton se PAE mbulon rreth mbi 70% të ngarkesës për të pesta vitet akademike si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="580 555 1366 972"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Total orësh</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE/PAK (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018-2019</td> <td>634</td> <td>563</td> <td>71</td> <td>89%/11%</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>1255</td> <td>893</td> <td>362</td> <td>71%/29%</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>1824</td> <td>1382</td> <td>442</td> <td>76%/24%</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>2498</td> <td>2041</td> <td>457</td> <td>82%/18%</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>3171</td> <td>2463</td> <td>708</td> <td>78%/22%</td> </tr> </tbody> </table>	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2018-2019	634	563	71	89%/11%	2019-2020	1255	893	362	71%/29%	2020-2021	1824	1382	442	76%/24%	2021-2022	2498	2041	457	82%/18%	2022-2023	3171	2463	708	78%/22%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																											
2018-2019	634	563	71	89%/11%																											
2019-2020	1255	893	362	71%/29%																											
2020-2021	1824	1382	442	76%/24%																											
2021-2022	2498	2041	457	82%/18%																											
2022-2023	3171	2463	708	78%/22%																											
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Personeli akademik me kohë të plotë ka pasur lëvizje të vazhdueshme, duke garantuar vetëm një bërthamë bazë të qëndrueshme (0.2 – Tabela 2). Aktualisht vetëm dy anëtarë të departamentit me formim arkitekt apo urbanist kanë qenë të angazhuar pa ndërprerje në 5 vitet e fundit si PAE. Ky numër rezulton më i qëndrueshëm në 2 vitet e fundit, ku katër anëtarë të departamentit me formim arkitekt apo urbanist kanë qenë të angazhuar pa ndërprerje si PAE.</p> <p>Anëtarë të departamentit me formim arkitekt apo urbanist 2018-2023:</p> <p>Elida Miraj: 22-23 / 21-22 / 20-21 / 19-20 / 18-19</p> <p>Enkelejda Prifti: 22-23 / 21-22 / 20-21 / 19-20 / 18-19</p> <p>Silvana Sukaj: 22-23 / 21-22 / 20-21</p> <p>Otjela Lubonja: 22-23 / 21-22</p> <p>Gentian Kaprata: 22-23 / 21-22</p> <p>Sabina Bollano: 22-23</p> <p>Jonila Prifti: 19-20</p>																														
	<p>Përsa i përket kontratave të punësimit, nga kontrolli i kampionëve në zyrën e burimeve njerëzore rezulton se ato janë të plota.</p>																														

<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në aspektin formal, institucioni rezulton i pajisur me procedurat e nevojshme për rekrutim cilësor, mbështetur mbi kriterë që mundësojnë përzgjedhje të personelit akademik në përputhje me nevojat e programit.</p> <p>Kriteret dhe procedurat përshkruhen në Rregulloren për burimet njerëzore të UET (11).</p> <p><i>Ndërkohë, angazhimi i personelit akademik me formim arkitekt apo urbanist me kualifikim të ciklit të tretë vlerësohet i pamjaftueshëm për nevojat e programit (shih Kriterin 1 të këtij Standardi).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në UET u konstatua funksionimi i laboratorëve të kompjuterit, të maketeve, të materialeve të ndërtimit dhe hapësira të tjera ndihmëse. Këto hapësira menaxhohen nga personeli akademik efektiv ose nga personeli administrativ. Nuk u konstatua prezenca e personelit ndihmës akademik të dedikuar për programin e studimit (0.2 Tabela 1 dhe 2).</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>UET i ruan të dhënat e personelit akademik në zyrën e burimeve njerëzore. Nga verifikimi i dosjeve që u krye pranë kësaj zyre nga GVJ rezulton se dokumentacioni i dosjes së personelit është i plotë dhe i përditësuar (44). Gjithashtu të dhënat për pesë vitet e fundit pasqyrohen në tabelën 2, ndërsa në tabelën 4 paraqitet angazhimi i detajuar i personelit akademik në aktivitetin mësimor për vitin 2022-2023 (0.2).</p> <p>Nuk u konstatua prania e personelit ndihmësakademik të angazhuar pranë departamentit apo programit të studimit.</p>



<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>UET ka paraqitur një listë marrëveshjesh bashkëpunimi me partnerë akademikë apo struktura biznesi me të cilët realizon praktikat profesionale (34, 35). Sipas RVB praktikat mësimore koordinohen përmes Zyrës së Karrierës dhe organizohen sipas një procesi të strukturuar (32).</p> <p>Syllabusi i lëndës Praktikë Profesionale nuk parashikon ndërveprim me kompanitë, por fokusohet tek procesi i aplikimit për një vend pune, etikën e komunikimit dhe teknologjinë e informacionit. Në syllabus thuhet që studentët duhet të vijnë në klasë me mjetet e vizatimit (19).</p> <p><i>Kjo përmbajtje vlerësohet e papërshtatshme nga GVJ për një program studimi të integruar të ciklit të dytë në Arkitekturë. Rekomandohet përshtatja e syllabusit dhe realizimi i një procesi ku studenti përfshihet në punë praktike reale duke marrë kështu eksperiencë profesionale.</i></p> <p>Procesi i diplomimit menaxhohet nga departamenti dhe bazohet në dokumentin e unifikuar në UET, B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit (19).</p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritisë që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Sipas RVB organizimi i praktikës profesionale mbështetet në dokumentin B.I. Mbi praktikën profesionale (32.1). Sipas këtij dokumenti thuhet:</p> <p><i>B.I.4.2. Praktika profesionale për programet Master i Shkencave ka 12 kredite; pra një detyrim prej 300 orë punë për studentin. Nga këto 8 orë në auditor (4 seanca nga 2 orë seanca), 240 orë në një institucion/organizatë/kompani dhe 52 orë janë punë individuale e studentit (takime me pedagogun, përgatitja e raportit përfundimtar etj).</i></p> <p>Referuar syllabusit të lëndës Praktikë Profesionale (19) dhe Planit Mësimor (14.2) kemi një mospërputhje në konceptin e organizimit dhe qëllimet e praktikës, numrin e krediteve dhe orët përkatëse (shih edhe Kriterin 7 të këtij Standardi).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se trupa akademike e programit të studimit është duke u konsoliduar në fund të ciklit të parë pesëvjeçar të këtij programi. Standardet sasiore në lidhje me personelin akademik përmbushen, por paraqiten mangësi në disa raste në nivelin e kërkuar të kualifikimit. Ndërkohë vihet re nevoja për mbështetje të programit me personel ndihmësakademik të dedikuar.</i></p>

	<i>Ngarkesa mësimore e personelit rezulton të jetë normale.</i> <i>Organizimi i praktikave mësimore kërkon vëmendje të veçantë dhe një strukturim të kujdesshëm.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Infrastruktura aktuale e UET garanton mjediset dhe kushtet e përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit të programit të studimit. Universiteti disponon 45 salla në të cilat zhvillohet aktiviteti akademik i programeve të studimit që ai ofron (42.1). Kampusi në rrugën Xhanfize Keko është një zgjidhje provizore në pritje të realizimit të një kampusi të ri bashkëkohor në periferi të Tiranës. Megjithatë, nga vizita e GVJ u konstatuan kushte normale pune për studentët dhe personelin akademik.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset e universitetit janë të pajisura me WiFi dhe me laboratore informatike. Sistemi MOODLE (UET LMS) ndihmon studentët dhe personelin akademik në komunikimin e përditshëm në lidhje me proceset didaktike. Ambiente të veçanta rezervohen për modelim apo realizim maketesh. Një laborator për testimin e materialeve të ndërtimit u vizitua nga GVJ. Gjithashtu, sallat e mësimdhënies kanë kushte normale për zhvillimin e mësimin dhe janë të pajisura me teknologjinë e nevojshme për zhvillimin e leksioneve, seminareve apo aktiviteteteve specifike (42.1). Duhet theksuar se godina ekzistuese është përshtatur për mjedise mësimore dhe si e tillë nuk paraqet në çdo rast zgjidhjet më të mira të mundshme. Hapësirat për Studiot e Arkitekturës janë relativisht të vogla.

	<p>Gjithsesi, gjatë vizitës nuk u vunë re aspekte problematike që ndikojnë në cilësinë e mësimdhënies.</p> <p>Në realizimin e kampusit të ri do të ishte e nevojshme krijimi i ambienteve të dedikuara për programin e studimit në Arkitekturë, me një qasje projektuese të veçantë kundrejt ambienteve të studiove.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Laboratorët e informatikës (7 laboratorë dhe 1 sallë internet) janë të pajisur me kompjuterë dhe me softet bazë për studentët. Studiot e arkitekturës realizohen në klasa me përmasa të vogla. Megjithëse salla më të mëdha do të ishin të preferueshme për të krijuar një atelier të mirëfilltë pune, gjykojmë që hapësirat përmbushin kushtet e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit mësimor.</p> <p>Krijimi i një laboratorit teknologjik për rilevimin, modelimin dhe prodhimin 3d me pajisje teknologjike dhe simulimin e realitetit do të mundësonte zhvillimin e programit të studimit përtej qasjeve klasike në formimin e arkitektëve duke ofruar një qasje më bashkëkohore.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Laboratorët e teknologjisë së informacionit janë 7 në rang universiteti (42.1). Këto laboratore përdoren nga të gjitha programet e studimit të ofruara në UET. Në një pjesë të tyre janë të instaluara programe profesionale që shfrytëzohen nga studentët e arkitekturës por edhe ata të arteve si p.sh. Auto Cad, 3d max, Photoshop etj.</p> <p>Gjithsesi, sot pajisja e studentëve me laptopë është në shkallë të gjerë dhe aksesin në teknologji apo mjete ndihmëse nuk paraqet pengesa.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave</p>	<p>Zhvillimi i praktikave profesionale në rastin e programeve të studimit në arkitekturë realizohet kryesisht në bashkëpunim me studio projektimi ose institucione publike. Për këtë program studimi janë paraqitur një seri marrëveshesh që sigurojnë mundësinë e bashkëpunimit për realizimin e plotë të veprimtarive praktike. Këto marrëveshje të paraqitura përfshijnë studio projektimi, kompani ndërtimi, institucione publike e private, OJF etj. (34).</p>

profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.									
Konkluzione	<i>UET rezulton me mjedise të mjaftueshme nga ana sasiore dhe cilësore për realizimin e përmbajtjes së kurrikulës. Infrastruktura aktuale ofron kushtet dhe teknologjinë e domosdoshme për një proces normal të mësimdhënies. Ekzistojnë kushtet e nevojshme për realizimin e praktikave mësimore në bashkëpunim me kompani apo institucione partnere. Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës dhe laboratoreve specifike do të kishte impakt në përmirësimin në vijim të programit.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Nga studimi i syllabuseve vihet re se është identifikuar literatura bazë dhe ndihmëse për çdo lëndë (19). Literatura është përgjithësisht e disponueshme në bibliotekë në formë fizike apo përmes sistemit UET LMS në formë elektronike. Në rastet kur literatura nuk disponohet, personeli akademik vendos në dispozicion shënime apo përmbledhje leksionesh të cilat plotësojnë nevojat e studentit për realizimin e procesit të parashikuar në syllabus. Një pjesë e literaturës ofrohet në gjuhën angleze, por GVJ në këtë rast nuk e sheh këtë si pengesë për zhvillimin e njohurive të studentëve.

<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Nuk u gjetën evidenca për përditësimin e literaturës specifike për programin e studimit gjatë viteve të fundit. RVB thekson se tekstet përditësohen duke synuar botimet e viteve të fundit, por nuk paraqet një dokument apo procedurë për realizimin e këtij procesi.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e UET ka një sipërfaqe prej 35 m² e cila shfrytëzohet nga i gjithë universiteti. Biblioteka ofron literaturë fizike dhe 45 vende studimi në një sallë të shkëputur (42.1). <i>Referuar manualeve dhe praktikave të mira të projektimit, kapaciteti i bibliotekës konsiderohet i vogël për numrin total të personelit akademik dhe studentëve në UET.</i> Zgjerimi i mëtejshëm i bibliotekës do të ndikonte pozitivisht jo vetëm në rritjen e cilësisë së programit MSc në Arkitekturë por të gjitha programeve të studimit në UET.</p> <p>Gjithsesi, mundësia e aksesit dhe përdorimit është e barabartë për studentët. Këtu duhet marrë parasysh se një pjesë e mirë e literaturës shërbehet përmes bibliotekave online të cilat mund të aksesohen në mënyrë të pavarur dhe të pakushtëzuar nga përdoruesit.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka ka një fond librash dhe literature fizike të kufizuar të cilët janë në dispozicion të programit të studimit (45). Rekomandohet që fondi i bibliotekës të pasurohet më tej dhe të përmbajë minimalisht në formë fizike literaturën bazë për çdo lëndë në përputhje me përmbajtjen e syllabuseve.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Shfrytëzimi i Bibliotekës në UET u krijon mundësi të barabartë studentëve për të marrë shërbim pa pagesë në sallë apo edhe në distancë përmes bibliotekave online. UET është e abonuar në Sage, Ebsco dhe Questia dhe disponon gjithashtu një katalog me libra elektronikë (0.2-Tabela 17).</p>

<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka e UET është e pajisur me infrastrukturën e nevojshme kompjuterike për të lehtësuar aksesin në materiale dhe rrjete. Përmes rrjetit COBISS studentët mund të aksesojnë edhe katalogun e bibliotekave të tjera në vend dhe në rajon.</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Oraret e deklaruara të bibliotekës janë 09.00-20.00 në ditët e javës dhe 9.00-17.00 ditën e Shtunë (45.1). Kjo kohëzgjatje konsiderohet optimale për të krijuar mundësi për studentët për shfrytëzimin e fondit.</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Në dokumentacionin e paraqitur ekziston formulari për pasurimin e fondit i cili plotësohet nga departamenti në bazë të kërkesave të personelit akademik (45.2). Ndërkohë që materialet elektronike të lidhura me lëndët vendosen në dispozicion të studentëve edhe përmes sistemeve të komunikimit (UET LMS), fondi fizik i bibliotekës ka nevojë për pasurim të mëtejshëm.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se UET ka një bibliotekë funksionale në mbështetje të programit të studimit. Vlerësojmë se sipërfaqja</i></p>

	<i>e bibliotekës është e vogël në raport me numrin e studentëve dhe literatura fizike ka nevojë të pasurohet më tej.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UET disponon një sistem menaxhimi të të dhënave përmes të cilit ruhen, administrohen dhe përpunohen të dhëna të shumëllojshme, në lidhje me studentin, të ardhurat, rekorde akademike etj. Sistemi informatik UMIS mundëson akses të shpejtë në databazë, lidhjen e informacionit në disa nivele si dhe gjenerimin e të dhënave analitike apo statistikave. Sistemet e informacionit në nivel universiteti administrohen nga zyra e TIK.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	UMIS administrohet nga personeli i UET me akses të dedikuar sipas rolit dhe pozicionit. Gjithashtu, MOODLE - UET Learning Management System është një sistem i cili i dedikohet ndërveprimit mes personelit akademik dhe studentit duke lehtësuar shpërndarjen e informacionit dhe komunikimin e vazhdueshëm në lidhje me ecurinë e aktiviteteve mësimore. Konkretisht, sistemi përdoret për shpërndarjen e literaturës, vlerësimet apo komunikimet periodike. UET ka hartuar urdhrat përkatës për vënien në funksion të sistemit, si dhe manualët e dedikuara për përdorimin nga studenti dhe personeli akademik (46.1, 46.2, 46.3).
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	UET LMS është aktiv prej vitit 2017 (46.1) dhe përfshin ciklin e plotë të programit të studimit MSH në Arkitekturë. Sistemi mundëson akses nga personeli akademik dhe studentët bazuar kryesisht në funksionet e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> - Njoftime periodike për të gjithë përdoruesit apo grupe përdoruesish;

	<ul style="list-style-type: none"> - Akses nga studentët në lëndët që ndjekin; - Akses nga pedagogët dhe editim i përmbajtjes në lëndët që ofrojnë; - Komunikim, shpërndarje informacioni, dhe realizim pyetësorësh. <p>[46.2, 46.3)</p>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Siç përshkruhet në Kriterin 2 dhe 3 të këtij Standardi, sistemi mundëson komunikim të lehtë dhe efikas. GVJ konstatoi se studentët dhe personeli akademik përdorin UET LMS dhe e vlerësojnë si mjet ndihmës dhe funksional për realizimin e komunikimit apo shkëmbimit të informacionit.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sipas RVB, UET LMS mundëson gjenerim të statistikave dhe të dhënave analitike. Këto të dhëna përdoren për proceset e monitorimit dhe zhvillimit të cilësisë në nivel universiteti, por edhe për hartimin e dokumentacionit për akreditimet. Gjithashtu, një parametër që monitorohet nga universiteti është edhe shkalla e përdorimit të sistemit, me qëllim nxitjen e përdorimit nga të gjithë në mënyrë frekvente.
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	<p>Faqja web zyrtare e UET ka përmbajtje në shqip dhe në anglisht mbi programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e realizuara etj.</p> <p>Informacioni mbi programin e studimit MSc në Arkitekturë trajton vetëm planin mësimor. Informacione të mëtejshme si historiku i programit, qëllimi, objektivat, forma e organizimit të studimeve, numri i studentëve, informacione mbi tregun e punës etj. do të ishin ndihmëse për studentët e rinj.</p> <p><i>chrome-https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2022/04/DINT-Arkitekture.pdf</i></p> <p><i>https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2022/04/Integrated-Msc.-Architecture.pdf</i></p> <p><i>https://uet.edu.al/fakulteti-i-inxhinierise-informatikes-e-arkitektures/</i></p>

	<p>https://uet.edu.al/en/fakulteti-i-inxhinierise-informatikes-e-arkitektures/</p> <p>Kurrikulumi i disa prej anëtarëve të personelit akademik të departamentit është vetëm në gjuhën shqipe (A.Sh., G.M., M. Ç., O.L., aksesuar në Gusht 2023). Gjithashtu mungon informacioni për personelin akademik me kohë të pjesshme.</p> <p>Një pjesë e njoftimeve në faqen e UET janë vetëm në gjuhën shqipe. https://uet.edu.al/en/te-rejat/</p>			
Konkluzione	<p><i>UET disponon një sistem të menaxhimit të informacionit dhe komunikimit efikas, i cili përdoret nga studentët, personeli akademik dhe ai administrativ. Përmbajtja e faqes së internetit mund të pasurohet më tej me informacione specifike mbi programin e studimit dhe me përditësimin e versionit në gjuhën angleze në disa raste.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Hartimi i buxheteve dhe analiza financiare rezulton të zhvillohet në nivel institucioni dhe jo e detajuar për departamentin apo programin e studimit. RVB e konsideron këtë praktikë të lidhur me karakterin e institucioneve jo publike të arsimit të lartë.</p> <p>Kjo qasje mund të konsiderohet deri diku funksionale në institucione të vogla, por gjithsesi analizat specifike për programe studimi me karakteristika dhe nevoja të veçanta si arkitektura janë të nevojshme.</p>

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>RVB thekson se plani i financimit hartohet në nivel institucioni dhe se për shkak të përmasave të institucionit është e pamundur të hartohen raporte për çdo program.</p> <p>Referuar ligjit të arsimit të lartë 80/2015, Neni 25 Departamenti:</p> <p><i>1. Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit... Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron.</i></p> <p><i>3. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimoreshkencore, në varësi të llojit të institucionit.</i></p> <p><i>7. Departamenti propozon programet e studimit, si edhe numrin e studentëve për çdo program, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të tij, sipas standardeve të cilësisë.</i></p> <p>Sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015, departamenti ka të nevojshme të ketë të dhëna financiare, raporte e analiza në mënyrë që të ofrojë programin e studimit dhe të përlllogarisë kapacitetet. Gjithashtu, departamenti duhet të hartojë kërkesat e tij për buxhetin të cilat duhet të miratohen dhe vihen në përdorim për mbarëvajtjen e programit të studimit. Departamenti duhet të ketë një buxhet të dedikuar për aktivitetet, kërkimin shkencor, pasurimin e fondit të bibliotekës të lidhur me programet e studimit, etj. Këto nevoja janë specifike dhe mund të përcaktohen vetëm nga departamenti.</p> <p><i>GJV sugjeron kryerjen e analizave specifike në nivel departamenti dhe për programin e studimit, për të garantuar qëndrueshmërinë e këtij të fundit, rritjen e vazhdueshme të performances, por edhe për të përfshirë departamentin në rolin e parashikuar nga ligji 80/2015.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Nga RVB dhe dokumentacioni i paraqitur rezulton se UET kryen auditim vjetor me auditues të jashtëm "Deloitte Albania". Informacioni i detajuar paraqitet në pasqyrat financiare dhe raportet e auditimit (50.1-50.7)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për</p>	<p>Siç u tha më sipër, buxhetet hartohen dhe menaxhohen në nivel institucioni dhe përfshirja e njësisë bazë nuk realizohet në</p>

programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	nivelelin e parashikuar nga Ligji 80/2015 (shih edhe Kriterin 2 të këtij Standardi).			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	<p>Nga ecuria e deritanishme vërehet qëndrueshmëri financiare në nivel institucioni. Kostoja vjetore për student ka ardhur në rënie (mbi 20% në periudhën 2017-2021), fakt që lidhet kryesisht me mirëmenaxhimin (0.2. Tabela 18.1).</p> <p>Në periudhën 2018-2020 paraqitet një rënie e të ardhurave me rreth 30% që impaktohet kryesisht nga reduktimi i të ardhurave përmes tarifave të studimit (0.2. Tabela 18.2).</p> <p>Këto të dhëna janë në nivel institucional, dhe nuk mundësojnë analiza specifike mbi programin e studimit apo njësinë bazë.</p>			
Konkluzione	<p><i>UET paraqet një situatë financiare të qëndrueshme që mbështet zhvillimin në tërësi të të gjitha programeve të studimit që ofron. Institucioni kryen auditime të rregullta dhe paraqet reduktim të kostove për student vit pas viti.</i></p> <p><i>Referuar kritereve të këtij standardi, roli i departamentit në planifikimin e buxheteve dhe kryerjen e analizave për zhvillimin e programit të studimit është ende i papërbushur.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	UET ka Statutin dhe rregulloret ku paraqiten politikat për organizimin e proceseve akademike (2, 5). UET ka një databazë të plotë për studentët ku regjistrohet veprimtaria e tyre akademike nga pranimi deri në diplomim. Gjithashtu u konstatua edhe prezenca e dokumentacionit fizik të parashikuara nga legjislacioni (regjistra, procesverbale etj.).
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Nga vizita në UET u konstatua se institucioni rezultoi aktiv në procedurat e pranimit dhe në ndjekjen e ecurisë së studentëve gjatë ciklit të studimeve. Në procedurën e pranimit u konstatua prania e një parakontrate (Dok. plotësues 4), e cila, në informacionin e dhënë për GVJ, rezultoi të jetë një dokument që i jep përparësi studentëve që rezervojnë të drejtën për të studiuar në UET, duke i avantazhuar ata kundrejt kandidatëve të tjerë e duke qenë prevalent kundrejt kriterit të meritës. Gjithashtu, sipas diskutimeve të kryera në takime kuptuam se ky dokument përcaktoi edhe tarifa më të favorshme për aplikantët që paraqiten më herët.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	UET vendos në dispozicion të të interesuarve të gjithë informacionin mbi kriteret e pranimit, procedurat, dokumentacionin apo kapacitetet për çdo vit akademik. Referuar informacionit të vënë në dispozicion (27.1) rezultoi se: Informimi dhe ndërgjegjësimi i studentëve për të ndjekur programet Master realizohet nëpërmjet këtyre formave: a. Organizim, në mjediset e UET-it, i takimeve informuese, sqaruese, dhe ndërgjegjësuese me grupe studentësh që shfaqin prirje për vijimin e studimeve në ciklin e dytë; b. Takime e biseda gjysmë formale në institucione e organizata ku mendohet se ka interes për ndjekjen e këtyre programeve;

	<p>c. Përgatitje e materialeve informuese – sqaruese – ndërgjegjësuere si: fletëpalosje, postera, broshura etj., dhe të atyre vizive si: spote televizive, mesazhe promovionale etj;</p> <p>d. Organizim logjistik, orientues, me mbështetje brenda burimeve njerëzore të UET-it të “Javëve të regjistrimit”, gjatë të cilave të interesuarit informohen, sqarohen, këshillohen mbi sistemin e studimeve për ciklin e dytë, procedurat e aplikimit dhe të pranimit dhe pajisen me dokumentacionin përkatës.</p> <p>Kriteret e Pranimit. Në këto programe pranohen për t’u regjistruar shtetasit shqiptarë ose të huaj, të cilët:</p> <p>a. kanë përfunduar studimet në një i) program studimi të ciklit të parë, në rastin e pranimit në programet e ciklit të dytë;</p> <p>b. dëshmojnë njohjen e një prej 5 gjuhëve të Bashkimit Europian (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht) përmes testeve të njohura ndërkombëtare, konform përcaktimeve me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.</p> <p>Dokumentacioni i kërkuar për regjistrim për programet e ciklit të dytë:</p> <p>a. Formulari i aplikimit;</p> <p>c. Fotokopje e noterizuar e diplomës dhe e certifikatës së notave të shkollës së mesme. Nëse diploma e kandidatit është lëshuar nga një institucion i huaj, duhet të shoqërohet me vërtetimin e nohjes dhe njësimit nga QSHA;</p> <p>d. Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës;</p> <p>e. Certifikatë familjare ose personale;</p> <p>Dëshmia e njohjes së një prej gjuhëve të huaja (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht) e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin;</p> <p>f. 2 fotografi për dokument;</p> <p>g. Kopje e mandatit të pagesës së tarifës së shkollimit.</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit si dhe personeli që ndjek pranimet angazhohen për të lehtësuar procesin e pranimit për kandidatët potencialë duke i asistuar ata gjatë gjithë</p>

studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	procesit. E njëjta qasje u vu re edhe për procesin e transferimit të studimeve ku asistenca shtrihet edhe në departamente (28, 12). Gjithashtu, kriteret e pranimit janë të disponueshme online në: https://uet.edu.al/si-te-aplikojme/
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Përtej informimit në web dhe media, UET organizon fushata informimi në mjediset e tij apo në mjedise të tjera (shkolla, panaire) duke rritur mundësinë e komunikimit me publikun. UET ka gjithashtu edhe politika marketingu në të cilat rezultojnë të jetë mjaft aktiv (51).
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	<i>Nuk u konstatuan kriteret të veçanta në përzgjedhje për kandidatët me aftësi të veçanta apo pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Në RVB deklarohet se institucioni është i hapur për të gjithë dhe ofron kushtet e nevojshme për këto kategori që të mund të studiojnë normalisht.</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Studentët e huaj duhet të përmbushin të njëjtat kriteret me studentët shqiptarë për t'u regjistruar në programin e studimit MSH në Arkitekturë. Programi ofrohet në gjuhën shqipe, kriter ky që lehtëson vetëm kandidatët që zotërojnë shqipen. Në rastin e diplomave të huaja, kërkohet njohja paraprake nga QSHA (27.1).
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Në RVB thuhet se UET akordon bursa sociale, por nuk mundëm të konstatojmë praktika të tilla të mbështetura në dokumentacion apo në kriteret publike për përfitimin e këtyre bursave.
Konkluzione	<i>UET rezultojnë se është mjaft i strukturuar në komunikim me studentët gjatë ciklit të studimeve dhe me studentët potencialë gjatë procesit të pranimit. Mendojmë se praktika e parakontratës duhet rishikuar në aspektet e krijimit të kushteve të barabarta për kandidatët potencialë, duke synuar promovimin e meritës dhe tarifa të unifikuar. Gjithashtu, rekomandohet hartimi i kriterëve</i>

	<i>të veçanta të pranimit apo mbështetjes për kandidatë me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Nga takimet e kryera gjatë vizitës rezulton se informacioni i nevojshëm për studentët është i aksesueshëm si nëpërmjet departamentit ashtu edhe përmes sekretarisë mësimore. Ecuria akademike pasqyrohet edhe përmes sistemeve të brendshme elektronike në të cilat studentët kanë akses të vazhdueshëm. Përmbledhje e rregullave dhe kriterëve për avancim akademik paraqitet në rregulloren mësimore të programit të studimit (7).
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>Studentët që kanë kryer studime të mëparshme asistohen nga Zyra e Kujdesit të Studentit dhe nga Departamenti. Procedura e njohjes së kualifikimeve bëhet duke qenë në kontakt të vazhdueshëm me studentin dhe bazohet në dokumentin e paraqitur mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin (28).</p> <p>Për të lehtësuar procedurën e transferimeve dhe për të informuar studentin kryhet një proces përkuplimentimi. Referuar dokumentit 28, hapat e paraekuivalentimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kandidati që dëshiron të transferohet nga një shkollë tjetër e lartë, në UET, duhet t'i paraqesë Zyrës së Pranimeve, një kërkesë ku të përcaktojë lëndët që dëshiron të transferojë, shoqëruar me një listë notash të lëshuar nga institucioni nga do të transferohet. - Dokumentacioni i kalon për shqyrtim paraprak Drejtuesit të Departamentit, i cili garanton që ekuivalentimi paraprak të përfundojë brenda ditës. - Kandidati njoftohet për ekuivalentimin paraprak nga Zyra e Pranimeve.

Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Rregullorja e programit të studimit (7) dhe syllabuset e lëndëve (19) kanë gjithë informacionin e nevojshëm mbi mënyrën e vlerësimit. Informimi bëhet nga personeli akademik me fillimin e lëndëve në çdo semestër. Nga takimi me studentët rezulton se ata janë të mirëinformuar mbi mënyrën dhe procedurat e vlerësimit.			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	UET ka hartuar procedura dhe dokumenta të unifikuar për diplomimin (10) ku paraqiten standardet, hapat e realizimit të punimit dhe procedura e mbrojtjes. Kalendari akademik udhëzon procesin dhe bëhet publik në çdo fillim viti (10.5). Nisur edhe nga numri i kufizuar i studentëve, informacioni merret lehtësisht në kontakte të drejtpërdrejta me personelin akademik apo strukturat e tjera në mbështetje të studentëve.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Për nga forma e organizimit UET rezulton mjaft aktive në marrëdhënien me studentin dhe informimin e tij. Java e orientimit organizohet në fillim të vitit akademik, ndërkohë komunikimi i vazhdueshëm me koordinatorin e programit të studimit dhe personelin akademik e atë administrativ është i vazhdueshëm dhe i thjeshtë për shkak të numrit të kufizuar të studentëve.			
Konkluzione	<i>GVJ mbështetur në vizitën në institucion dhe dokumentacion e vënë në dispozicion, vuri re një sistem komunikimi funksional dhe efikas mes studentëve dhe institucionit në të gjitha hallkat. Shkalla e informimit të studentëve në lidhje me proceset akademike rezulton mjaft e mirë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Informacioni fillestar për strukturën dhe kohëzgjatjen e programit të studimit është i disponueshëm online në: https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2022/04/DINT-Arkitecture.pdf</p> <p>Procesi i regjistrimit kalon në disa hapa ku studentët e rinj informohen përmes kontakteve të vazhdueshme me personelin akademik dhe administrativ dhe konkludon me nënshkrimin e kontratës ku përcaktohen elementët bazë të organizimit të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Syllabuset e kurseve (19) u vihen në dispozicion studentëve në fillim të çdo aktiviteti akademik. Përmbajtja e syllabuseve rezulton e detajuar dhe e qartë për informimin e studentëve. Nga takimi me studentët GVJ konstatoi se ata janë të informuar për përmbajtjen dhe organizimin e lëndëve.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Nga takimet me strukturat përgjegjëse për këshillimin e karrierës rezulton se UET ka një zyrë funksionale për këshillimin e karrierës dhe kujdesin ndaj studentit (12).</p> <p>Gjithashtu u vu re një angazhim aktiv në krijimin e kontakteve me tregun e punës si në rastin e organizimit të përvitshëm të Panairit të Tregut të Punës apo të aktivitetit të Bordit të Punës (12.1, 12.2).</p> <p>Gjithashtu, nisur nga natyra specifike e studimeve në arkitekturë, kontaktet me tregun e punës përmes personelit akademik janë mjaft aktive.</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Informacionet bazë mbi të gjitha aspektet e ofertës akademike janë të aksesueshme në uet.edu.al</p> <p>Koordinatori i programit të studimit (36) mbulon marrëdhëniet e përditshme me studentët dhe ka informacion të hollësishëm për të gjitha proceset akademike.</p> <p>Informacione dhe njoftime të vazhdueshme dërgohen edhe përmes sistemeve elektronike të komunikimit.</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i</p>	<p>Përmes komunikimit me email dhe platformës LMS (46.1, 46.3) mundësohet mbulimi i pjesës më të madhe të komunikimit mes studentëve dhe personelit akademik. Nga takimi me studentët u vu re se komunikimi ishte aktiv jo vetëm fizikisht por edhe përmes formave të komunikimit elektronik.</p>

arritshëm nga studentët edhe në distancë.				
Konkluzione	<i>GVJ mbështetur në vizitën në institucion dhe dokumentacion e vënë në dispozicion, vuri re një sistem komunikim funksional dhe efikas mes studentëve dhe institucionit në të gjitha hallkat. Shkalla e informimit të studentëve në lidhje me strukturën akademike, veprimtaritë formuese, dhe mundësitë e punësimit rezulton mjaft e mirë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve				
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Nga verifikimi gjatë vizitës rezulton se sekretaria mësimore ka dokumentacion të plotë mbi numrin e studentëve (29, 27). Programi i studimit nuk ka ende të diplomuar.				
	Viti akademik	Programi/profili	Te regjistruar për herë të parë	Të transferuar	Totali
	2018-2019	Arkitekturë Interieri	2		2
		Urbanistikë"	2	1	3
	2019-2020	Arkitekturë Interieri	28	1	29
		Urbanistikë"	3	2	5
	2020-2021	Arkitekturë Interieri	25	2	27
		Urbanistikë"	12	1	13
	2021-2022	Arkitekturë Interieri	35	3	38
		Urbanistikë"	3	-	3
2022-2023	Arkitekturë Interieri	37	8	45	
	Urbanistikë"	6	1	7	

<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Të dhënat e parashikuara në Kriterin 2 rezultojnë të plota për kohëzgjatjen e programit të studimit. Përveç dokumentacionit zyrtar të konstatuar në sekretarinë mësimore, UET përdor edhe sistemin UMIS (46) ku janë të dublikuara të dhënat në formë elektronike. Përmes këtij sistemi mund të gjenerohen statistika dhe analiza më komplekse.</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sistemi UMIS (University Management Information System) (46) administrohet nga zyra e teknologjisë së informacionit dhe përmban një seri të dhënash në lidhje me studentin dhe mbarëvajtjen e proceseve akademike e atyre financiare. Personat e autorizuar kanë akses në nivele të ndryshme informacioni sipas pozicionit të tyre të punës.</p> <p>Sistemi mundëson:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Menaxhimin e kontratave; - Menaxhimin e të dhënave të programit përmes koordinatorit; - Menaxhimin e orarit; - Gjenerimin e statistikave; - Menaxhimin e lëndëve.
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me</p>	<p>Sekretaria mësimore mban dokumentacionin bazë të studentëve ku përfshihet edhe dosja e studentit. Gjithashtu aty dokumentohet edhe ecuria akademike e çdo studenti në bazë të regjistrave dhe formateve standarde (9). Nga vizita në sekretari rezultoi se dokumentacioni ishte i plotë dhe i rregullt.</p> <p>Gjithashtu, siç përshkruhet në Kriterin 3 të këtij Standardi, sistemi UMIS dublikon të dhënat dhe lehtëson aksesin në to.</p>

veprimtarinë e tyre përkatëse.									
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>Nga vizita u konstatua se departamenti ishte funksional dhe i angazhuar me mbarëvajtjen e proceseve akademike. Mbledhjet periodike trajtojnë edhe ecurinë e aktivitetit duke synuar përmirësim të vazhdueshëm.</p> <p>Ekzistojnë edhe dokumente analitike ku përmblihet ecuria e proceseve mësimore, siç paraqitet në dokumentin 38.</p>								
Konkluzione	<i>UET rezulton i mirëorganizuar në procesin e ruajtjes dhe aksesimit të të dhënave në lidhje me studentët dhe ecurinë e tyre akademike. Përtej dokumentacionit fizik, mundësohet edhe ruajtja dhe përpunimi i dokumentave përmes sistemeve elektronike.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>Studentët në UET kanë të drejtë të përfaqësohen në struktura të niveleve të ndryshme në përputhje me rregulloret dhe statutin (2) e universitetit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Senati akademik – 3 përfaqësues sipas nenit 19.2.4 të statutit; - Këshilli i etikës - 1 përfaqësues sipas nenit 19.6 të statutit; - KSBC – 1 përfaqësues sipas nenit 16 të statutit; - Këshilli i studentëve – zgjidhet çdo 2 vjet sipas nenit 51 të statutit;

	- Grupeve të vlerësimit të brendshëm në kuadër të akreditimeve.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Nga takimet me studentët u konstatua se përfshirja e studentëve në përgjithësi është në nivele të kënaqshme. Komunikimi është i vazhdueshëm dhe studentët marrin pjesë aktive edhe në diskutime apo analiza periodike. Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës ka paraqitur edhe evidenca për organizimin e mbledhjeve të hapura me studentë ku diskutohen aspekte të ndryshme të mësimdhënies (38.1). Numri i kufizuar i studentëve bën që instrumentet e aplikuara për përfshirjen e tyre në të gjitha nivelet e organizimit të jenë efikase.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Pyetësorët periodikë të realizuar për sigurimin e brendshëm të cilësisë (40) janë një formë tjetër e vjeljes së mendimit të studentëve për zhvillimin e analizave periodike me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit të studimit. Gjithashtu siç paraqitet në evidencën 38.1, mbledhjet e hapura me pjesëmarrjen e studentëve janë një praktikë e mirë që ndihmon në shkëmbimin e mendimeve mbi ecurinë e programit të studimit.
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Konrolli i dijeve realizohet në përputhje me procedurat e parashikuara në rregulloren e UET (5), rregulloren e programit të studimit (7) dhe syllabusin e lëndës (19). Konrolli i dijeve është i vazhduar dhe i ndarë në komponentë (7.2). Studenti ka të drejtën e informimit mbi mënyrën e vlerësimit si dhe të ankimit përmes një formulari tip (40.2). Referuar rregullores së UET: <i>Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (kolokium, provim i ndërmjetëm, detyrë kursi/detyra praktike, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës ai mund t'i drejtojë Drejtuesit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrijë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Drejtuesi i Departamentit ose Dekani, kur pedagogu i</i>

	<p><i>lëndës është vetë Drejtuesi i Departamentit, ngre një Komision të përbërë nga 3 pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vlerësimi që bën komisioni, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar.</i></p> <p>Megjithëse mekanizmat e ankimimit ekzistojnë, nuk u evidentuan raste kur ka qenë e nevojshme të aplikohet kjo procedurë.</p>			
Konkluzione	<p><i>Rezultoni se përfshirja e studentëve në strukturat e universitetit është e kënaqshme. Përfshirja nuk është vetëm formale por realizohet në mënyrë të vazhduar përmes komunikimit në nivele të ndryshme. Në këtë kontekst, GVJ mendon se standardi dhe kriteret përkatëse përmbushen plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit është njësi e posaçme që asiston studentin gjatë gjithë periudhës së tij të studimeve. Sipas dokumentit 12, zyra ka funksionet e mëposhtme.</p> <p>Zyra e Kujdesit ndaj Studentit (ZKS) shërben si burim primar i informacionit dhe këshillave rreth mundësive të studimit.</p> <p>ZKS kujdeset veçanërisht për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Qeverisjen dhe aktivitetet e studentëve, programet e ndryshme të lidhshme të liderit të studentëve dhe eventet speciale të mëdha në kampus; - Klubet dhe organizimet e studentëve; - Qeverinë studentore; - Shkollat stimore për studentët; - Trajnime online të studentëve për çështje të ndryshme; - Ankesat e studentëve – formale dhe konfidenciale;

	<ul style="list-style-type: none"> - Burimet elektronike të përdorura nga studentët (adresa elektronike dhe LMS).
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Përtej Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, çështjet që lidhen drejtpërdrejt me programin e studimit ndiqen nga koordinatori i programit të studimit (36) apo nga sekretaria mësimore (9).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të paraqitur, Zyra e Këshillimit të Karrierës (12) e zhvillon aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti, si dhe duke u diferencuar në funksion të nivelit të studimit.</p> <p>Shërbimet kryesore që ofron zyra janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Këshillim të vazhdueshëm për studentët, duke i mbështetur në hartimin e CV, Letrës së motivimit & Korrespondencën me zyrat e Burimeve Njerëzore të kompanive/organizatave; - Këshillim të studentëve për faza të intervistës së punës; - Përgatit kalendarin e eventeve të lidhura me industrinë – Open Day për çdo fakultet dhe panaiet e punës; - Zhvillon sondazhin e planit të karrierës së studentëve; - Mentorim & Networking; - Gjurmon studentët pas diplomimit dhe përpunon statistika mbi Alumnin; sa integrohen në tregun e punës, vazhdojnë studimet, etj.; - Database me burime të mundësive të ndryshme për punësim, internship, bursa studimi, etj, duke i shpërndarë njoftimet tek studentët për të cilët mund të kenë interes. - Organizimi i proceseve të rekrutimit në universitet.
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua</p>	<p>Siç referohet në Kriterin 3 të këtij Standardi, zyra e karrierës është funksionale. Kjo zyrë gjurmon ecurinë e studentëve pas diplomimit. Gjithashtu, ajo mban databazën e Alumni dhe gjeneron edhe statistika mbi nivelet e punësimit të cilat analizohen më tej nga strukturat e tjera të universitetit. Për programin MSH në Arkitekturë, nuk kemi ende të diplomuar.</p>

vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.				
Konkluzione	<i>UET ka struktura funksionale për mbështetjen e studentëve gjatë studimeve. Zyra e Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, Koordinator i Programit të Studimit dhe Sekretaria Mësimore, janë tre struktura funksionale dhe aktive të cilat orientojnë, ndërmjetësojnë dhe lehtësojnë marrëdhënien e studentit me institucionin. Gjithashtu, zyra e karrierës ndjek edhe ecurinë e studentëve pas diplomimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga UET vihet re një angazhim serioz në ngritjen dhe organizimin e strukturave për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Në nivel institucional është hartuar manuali i SBC (30.2), ku përcaktohen veç të tjerave edhe formatet e syllabuseve, metodologjia për monitorimin e provimeve, indikatorët për matjen e performancës akademike etj. Referuar dokumentit 33, Trajnime Profesionale, në vitin akademik 2019-2020 është realizuar trajnimi "UET 2020: mësimdhënia, cilësia, strukturimi" për pedagogët e Universitetit ku profesorë me tituj akademik trajnuan pedagogët mbi metodat e reja të

	mësimdhënies, inovacionit si dhe trajnim mbi përdorimin e platformës elektronike LMS.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	<p>UET ka të ngritur strukturat për SBC në disa nivele. Referuar dokumentit 8, Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë këto struktura janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Strukturat hierarkike organizative të UET-it; - Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, e cila kujdeset për hartimin, përditësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet e cilësisë dhe praktikat e mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe monitoron zbatueshmërinë e tyre nga strukturat dhe personeli i institucionit. - Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë – KSBC, nëpërmjet vlerësimit të efikasitetit të veprimtarive që ushtrohen në UET, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. <p>Monitorimi i personelit akademik realizohet përmes punës së përditshme të departamentit, vlerësimeve të eprorëve apo kolegëve (30.16), vetëvlerësimit (41) si dhe pyetësorve të realizuar me studentët.</p>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	<p>Vlerësimet periodike për mësimdhënien nga studentët organizohen nga Komisioni i SBC, i cili është përgjegjës për realizimin e sondazheve dhe analizave mbi cilësinë e mësimdhënies. Referuar dokumentit 8, Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë, KSBC përbëhet nga Kryetari i Komisionit, një përfaqësues nga pedagogët e çdo Fakulteti, një përfaqësues nga personeli ndihmës akademik, ose administrativ, një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, si dhe të paktën një përfaqësues ekspert i jashtëm.</p> <p>Komisioni vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore ose artistike, si dhe efikasitetin e veprimtarive administrative dhe financiare të institucionit.</p> <p>Studenti ka të drejtën e informimit mbi mënyrën e vlerësimit si dhe të ankimit përmes një formulari tip (40.2).</p> <p>Referuar rregullores së UET (5):</p>

	<p><i>Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (kolokium, provim i ndërmjetëm, detyrë kursi/detyra praktike, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës ai mund t'i drejtojë Drejtuesit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrijë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Drejtuesi i Departamentit ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë Drejtuesi i Departamentit, ngre një Komision të përbërë nga 3 pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vlerësimi që bën komisioni, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Megjithëse raportet e vlerësimeve mbi cilësinë ekzistojnë dhe qarkullohen tek personeli akademik (30.8, 30.15), nuk u evidentua publikimi i të dhënave për sigurimin e cilësisë me lehtësi aksesimi nga studentët apo edhe personeli akademik. Rekomandohet bërja publike e raporteve vjetore mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë, duke paraqitur të paktën të dhënat bazë dhe ato të mesatarizuara mbi indikatorët e cilësisë që monitorohen në mënyrë periodike. Publikimi në faqen web të universitetit do të rriste nivelin e informacionit dhe të transparencës, sidomos me studentët.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ vuri re një përpjekje për organizimin e trajnimeve dhe aktiviteteve të vazhdueshme, përmes së cilave synohet edhe rritja e cilësisë së mësimdhënies (33). Ndarja e praktikave të mira mes kolegësh apo promovimi i rasteve të suksesit kryhet përmes komunikimi standard institucional, pa praktika të veçanta të evidentuara.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se UET ka struktura funksionale mbi sigurimin e cilësisë të cilat angazhohen në mënyrë të vazhdueshme për të monitoruar, vlerësuar dhe përmirësuar proceset. Në këtë mekanizëm kontribuojnë si personeli akademik, ashtue edhe studentët.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	
			<p>X</p>	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>GVJ konstatoi se UET ka ngritur strukturat për SBC në përputhje me parashikimet ligjore. Referuar Statutit të universitetit (2), Neni 11 dhe Neni 16, është ngritur Komisioni për SBC si strukturë e përhershme për këtë qëllim.</p> <p>Dokumente të tjera që janë paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri janë: Manuali i SBC (30.2), Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë (8), Strategjia për sigurimin e cilësisë (30.3), Metodologjia e punës së KSBC provimet (30.5), Metodologjia e punës së KSBC silabuset (30.9), Metodologjia e punës së KSBC Fokus-Grup (30.13).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në Strategjinë për sigurimin e cilësisë (30.3) parashikohet përfshirja e studentëve dhe ekspertëve të jashtëm:</p> <p><i>UET bazohet në parimet e ISO 9001-2015 për të ndërtuar paketën e menaxhimit të cilësisë të përqendruar në zhvillimin efektiv, zbatimin dhe monitorimin e politikave dhe procedurave të cilësisë.</i></p> <p><i>Parimi 1: Studenti në fokus. (Student Centred approach). Ky parim nënkupton përfshirjen e studentëve përmes marrëdhënieve proaktive student-staf, qasjeve të mësimnxënies aktive dhe mekanizmave transparente dhe llogaridhënëse të mbështetjes së tyre. Studentët duhet ta ndiejnë që zëri i tyre dëgjohet, që ata kontribuojnë në procesin e të nxënës dhe ndajnë eksperiencat e tyre me të tjerët, si edhe e ndiejnë veten pjesë të institucionit.</i></p> <p>Në përbërjen e KSBC sipas dokumentit 30.4 parashikohet përfshirja në të e ekspertit të jashtëm dhe përfaqësuesit të studentëve.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të</p>	<p>U konstatua se UET realizon një seri vlerësimesh periodike, sondazhesh dhe analizash me qëllim SBC (30.7, 30.8, 30.11, 30.12, 30.14, 30.15, 30.16, 30.17, 41).</p> <p>Ndërkohë akreditimet periodike dhe vlerësimet e jashtëme të cilësisë janë praktikë e rregullt e institucionit. Për programin e studimit MSH në Arkitekturë ky është akreditimi i parë.</p>

akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.									
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Dokumentet e përmendura në Kriterin 3 dëshmojnë përdorimin e treguesve të matshëm për mësimdhënie dhe analizat e mëtejshme për SBC. Më konkretisht: Shembull Raporti për provimet Sem 1_v.a.21-22 - DIA_FILA (30.8); Shembull Relacion DIA Monitorimi i Silabuseve_Sem I_2021-2022 (30.12); Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu (30.16); Shembull vlerësim nga eprori (30.17). Gjithashtu UET monitoron edhe veprimtarinë kërkimore të personelit akademik (43).								
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi pajisjen e UET me strukturat dhe instrumentet e nevojshëm për monitorimin e cilësisë akademike, këto të reflektuara në evidencat e paraqitura në dokumentacionin e akreditimit.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për	Raportet e vlerësimit në nivel institucioni dhe të dhënat përkatëse që lidhen për programin e studimit MSH në Arkitekturë shqyrtohen dhe analizohen në nivel Rektorati, Fakulteti dhe Departamenti duke krijuar kështu mekanizma për monitorimin por edhe përmirësimin

<p>shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>e cilësisë së programit. Në dokumentacionin shoqërues të RVB paraqiten:</p> <p>Shembull Raporti për provimet Sem 1_v.a.21-22 - DIA_FIIA (30.8);</p> <p>Shembull Relacion DIA Monitorimi i Silabuseve_Sem I_2021-2022 (30.12);</p> <p>Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu (30.16);</p> <p>Shembull vlerësim nga eprori (30.17);</p> <p>Mbledhje të hapura me studentë (38.1);</p> <p>Minuta të mbledhjes së Bordit të Tregut të Punës_2021 (12.2).</p> <p>Meqenëse ky është akreditimi i parë i programit të studimit, Departamenti nuk ka ndërmarrë hapa të dukshëm për ndryshim në program, të cilat do të duhej të aplikoheshin në vijim në përputhje me gjetjet që evidentohen në analizat e paraqitura dhe me rekomandimet e këtij raporti.</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Megjithëse nuk u konstatua një dokumentim i strukturuar i marrjes së masave konkrete mbi gjetjet e vlerësimeve, dokumentet e paraqitura në Kriterin 1 të këtij standardi dëshmojnë se ekziston angazhimi i të gjithë aktorëve të nevojshëm në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë të realizuar përmes proceseve periodike.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit,</p>	<p>Metodat që përdoren në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies janë testimet, vlerësimi i praktikave, provimet si dhe vlerësimi i vazhduar sidomos në studiot e arkitekturës, proces specifik i këtij programi studimi (7.3, 19, 30.5, 30.6, 30.7, 30.8, 32.2) .</p> <p>Gjithashtu monitorimi i praktikave mësimore dhe vlerësimi i personelit akademik nga kolegët dhe eprorët përmes prezencës në auditor, janë instrumente dhe praktika që aplikohen sipas dokumentacionit të paraqitur (30.16, 30.17).</p>

<p>vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>				
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Metodat e vlerësimeve të tërthorta bazohen kryesisht në sondazhet periodike që realizohen me studentët dhe fokus grupet (40, 30.5, 30.13, 30.14, 30.15, 38.2). Duke qenë se numri i studentëve është relativisht i vogël, vjelja e mendimeve dhe perceptimeve realizohet lehtësisht edhe përmes komunikimit të përditshëm me personelin akademik, koordinatorin e programit apo drejtuesin e departamentit (38.1).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Përmes KSBC dhe Departamentit realizohen një seri procedurash dhe vlerësimesh, si për proceset rutinë didaktike ashtu edhe për cilësinë e mësimdhënies në përgjithësi. Ekzistojnë metodat e drejtpërdrejta si dhe ato të tërthorta.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Përfshirja e aktorëve të jashtëm realizohet përmes disa mekanizmave:</p> <ul style="list-style-type: none">- Përfshirja e ekspertit të jashtëm F. M. në strukturat e cilësisë (30.4);- Përmes strukturës së Bordit të Tregut të Punës (12.1);- Përmes projekteve të dedikuara për cilësinë ku UET është përfshirë si ENCHASE (30.9) dhe QAINAL (30.10);- Përmes aktiviteteve dhe takimeve të organizuara në nivel universiteti apo të lidhura me programin e studimit (55.1, 55.2);- Përmes mobiliteteve Erasmus të personelit akademik (28.5).
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Përgjegjësitë dhe rolet për proceset e SBC përcaktohen në Statut (2), në dokumentin mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë (8), në Strategjinë për sigurimin e cilësisë (30.3) dhe në urdhrat dhe komunikimet e brendshme për ngritjen dhe funksionimin e strukturave (30.4).</p> <p>Në këto dokumente parashikohet funksionimi permanent i KSBC dhe angazhimi në të gjitha nivelet (Rektorat, Fakultete, Departament) i personelit akademik për ndjekjen e proceseve të cilësisë. Në nivel departamenti, pesha kryesore i përket drejtuesve të departamenteve dhe koordinatorëve të programeve të studimit.</p> <p>Gjithashtu, siç u përmend më sipër, në këto dokumente parashikohet edhe përfshirja e studentëve dhe ekspertëve të jashtëm.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe</p>	<p>Në urdhrin administrativ për përbërjen e KSBC (30.4), përcaktohet përbërja e KSBC, ku si përfaqësues i Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës është caktuar S.S. Gjithashtu, në të njëjtin dokument parashikohet edhe përfshirja në këtë komision e personelit administrativ, studentëve, administratës dhe një eksperti të jashtëm.</p> <p>Njësia bazë mbetet e papërfaqësuar, duke u bërë pjesë vetëm në proceset dytësore që burojnë nga veprimtaria e KSBC. Gjithsesi,</p>

studentëve të programit të studimit.	njësia bazë angazhohet në analizat periodike dhe në hartimin e RVB për programet e studimit që mbulon.			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	<p>Nga vizita në institucion nuk u perceptua asnjë problematikë e lidhur me integritetin akademik, diskriminimin apo pabarazinë. Gjithsesi, UET është kujdesur të shmangë konfliktet e tërthorta që burojnë nga mbivendosja e detyrave dhe ka vendosur edhe kritere apo parime për anëtarët e KSBC. Referuar në dokumentin Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë (8), pika 7.3, në përzgjedhjen e anëtarëve të KSBC merren parasysh kriteret e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> Kompetencat profesionale; Cilësitë personale (si ndershmëria, korrektesa, serioziteti, përgjegjshmëria, etj.); Ngarkesa mësimore apo ngarkesa me kryerjen e funksioneve të tjera administrative; Eksperienca e mëparshme në detyrë të njëjtë apo të përafërt; Të mos jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të UET-it. 			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<p>Siç evidentohet në Kriterin 1 të këtij Standardi, përfshirja e aktorëve të jashtëm realizohet përmes disa mekanizmave:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përfshirja e ekspertit të jashtëm F. M. në strukturat e cilësisë (30.4); - Përmes strukturës së Bordit të Tregut të Punës (12.1); - Përmes projekteve të dedikuara për cilësinë ku UET është përfshirë si ENCHASE (30.9) dhe QAINAL (30.10); - Përmes aktiviteteve dhe takimeve të organizuara në nivel universiteti apo të lidhura me programin e studimit (55.1, 55.2); - Përmes mobiliteteve Erasmus të personelit akademik (28.5). <p>Të lidhur drejtpërdrejtë me tregun e punës për programin e studimit MSH në arkitekturë, rezultojnë 12 anëtarë të Bordit të Tregut të Punës (12.1).</p>			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se KSBC është funksional dhe në proceset që iniciohen nga ky komision ka gjithëpërfshirje të aktorëve, duke filluar nga studentët, ekspertët e jashtëm, personeli akademik, ai administrativ etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Megjithëse KSBC ka një agjendë vjetore të aktiviteteve dhe proceseve e cila është bashkëlidhur në dokumentacionin e GVB (30.1), ky informacion për SBC, nuk është i aksesueshëm në web.</p> <p>Ndërkohë ekziston strategjia për SBC (30.3) e cila është e aksesueshme në web: https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Strategjia-per-sigurimin-e-cilesise-2023-2028-WEB.pdf</p> <p>Për të rritur nivelin e transparencës, institucioni duhet të shqyrtojë forma të ndryshme të publikimit të informacioneve përtej vendosjes në dispozicion të materialeve vetëm për të interesuarit. Sugjerohet të bëhen publike në web RVB, RVJ, Raporte vjetore për SBC, kalendari i aktiviteteve të KSBC, etj.</p>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<p>RVB thekson që raportet e KSBC përmbajnë të dhëna personale dhe sensitive, duke e paraqitur këtë si argument për mos publikimin e raporteve dhe për trajtimin e tyre vetëm përmes organeve dhe autoriteteve drejtuese. GVJ vlerëson se raportet e KSBC mund të jenë publike në përputhje me parashikimet e Kriterit 2. Kjo mund të realizohet duke fshirë informacionet sensitive dhe personale nga raporti, ose duke hartuar përmbledhje të shkurtuar të raportit për publikim, ku ilustrohen nga ana statistikore dhe analitike vetëm indikatorët kryesorë dhe evoluimi i tyre.</p>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	<p>Ka evidenca për ndjekjen e proceseve dhe analiza të mëtejshme (38.1, 38.2), por jo indikatorë të matshëm apo plane veprimi ku specifikohen afate, persona përgjegjës dhe rezultate të pritshme për çdo proces.</p> <p>Sipas RVB ka një follow up kryesisht të bazuar mbi rezultatet e pyetësorëve të studentëve, ku janë marrë masa, nga diskutimi i problematikave, në realizimin e trajnimeve (33), e deri në pezullime</p>

	të kontratave. Në programin e studimit MSH në Arkitekturë janë evidentuar vetëm realizimi i mbledhjeve dhe trajnimeve.			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Ekzistojnë një seri mekanizmesh që ndërthuren me sistemin e SBC të përcaktuara në Statutin dhe rregulloret e universitetit. Të gjitha pozicionet dhe strukturat duke filluar nga grupet mësimore, koordinatori i programit, drejtuesi i departamentit, dekani dhe strukturat e rektoratit janë të përfshirë në mënyrë direkte dhe indirekte në SBC sipas përcaktimeve të Statutit[2]. Ndërveprimi i vazhdueshëm i këtyre strukturave siguron efektivitetin e nevojshëm për mbarëvajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit MSH në Arkitekturë.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Përveç kalendarit vjetor të aktiviteteve (33, 55.1, 55.2) ku ka edhe aktivitete të dedikuara apo që trajtojnë edhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, UET realizon edhe Javën e informimit ku mundësohet informacion i detajuar për programet e studimit, ecurinë e tyre dhe raportet me tregun e punës.			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se ka një sistem funksional cilësie i cili ka rezultuar i suksesshëm në krijimin e një kulture të SBC në UET. U vu re që raportet dhe analizat mbi çështjet e cilësisë trajtohen kryesisht nëpërmjet praktikave zyrtare dhe administrative të brendshme pa mundësuar publikimin dhe aksesimin e lehtë dhe të pavarur nga studentët apo të interesuarit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Program i Integruar i Nivelit të Dytë “Master në Arkitekturë” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi MSH në Arkitekturë rezulton i konsoliduar dhe i strukturuar në përputhje me kornizën ligjore.
2. UET ka një sistem funksional të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

Pika të dobëta

1. Profilizimi nuk krijon diferencë të qartë mes dy drejtimeve (profileve) për të cilat ofrohet diploma (*Standardi 2.4, Kriteri 1*).
2. Infrastruktura specifike për studimet e arkitekturës dhe urbanistikës (*Standardi 4.2, Kriteri 1, 2, 3*).
3. Personeli akademik nuk përmbush në të gjitha rastet kriteret e kualifikimit në raport me angazhimin e tij në mësimdhënie në vitin e katërt dhe të pestë të programit të studimit (*Standardi 4.1, Kriteri 1*).

Rekomandime

1. Definimi i qartë i lëndëve të cilat saktësojnë fushën e specializimit.
2. Përfshirja e lëndës: Arkitektura moderne dhe trendet bashkëkohore në kurrikulë, si pjesë e interpretimit historik të stileve dhe zhvillimeve në arkitekturë.
3. Në vitin e katërt dhe të pestë të angazhohet personel akademik me kualifikim minimal të ciklit të tretë të studimeve, sipas përcaktimeve të Ligjit 80/2015 Neni 59.6. Rekomandohet reduktimi i kapaciteteve pritëse në këtë program studimi deri në garantimin e plotë të përputhshmërisë me kërkesat mbi kualifikimin e personelit akademik.
4. Rekomandohet rishikimi i planit mësimor me qëllim rritjen e ngarkesës javore në orë për studion e projektimit si lënda bazë e formimit në disiplinën e arkitekturës.
5. Rekrutimi i të paktën një personeli ndihmës akademik të dedikuar për programin e studimit do të ishte i nevojshëm për mbarëvajtjen e laboratorëve dhe për asistencën në proceset e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.
6. Rekomandohet rishikimi i syllabusit të praktikës profesionale në vitin e pestë, duke synuar që studenti të zhvillojë një periudhë pune në një kompani ose institucion, me qëllim zhvillimin e aftësive të tij profesionale.

7. Rekomandohet hartimi i planeve dhe analizave financiare në nivel departamenti dhe program studimi sipas parashikimeve të kodit të cilësisë *S.IV.5, K.1., K.2.*
8. Rekomandohet rritja e sipërfaqes së bibliotekës dhe pasurimi më tej i fondit duke garantuar në formë fizike literaturën bazë të parashikuar në syllabuset e lëndëve.
9. Të bëhet publikimi i raporteve apo raporteve të shkurtuara të KSBC në përputhje me *Standardin VI.5 Kriteri 2.*

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Integrated Second Level Program "Master in Architecture" provided by the Higher Education Institution "European University of Tirana."

Strengths and affirmations

1. The MSc in Architecture results in a well-consolidated and structured programme fulfilling the legal framework.
2. UET has built a functional Quality Assurance System


Weaknesses

1. The profilisation of the program does not provide a clear difference in formation between the two profiles (*S.2.4, K.1*).
2. Specific infrastructure for architecture and urban planning studies (*S.4.2, K. 1, 2, 3*).
3. In all cases, the teaching staff does not fulfill the criteria on the qualification related to the engagement in the fourth and fifth year of the program (*S. 4.1, K. 1*).

Recommendation

1. Clear definition of subjects that specify the field of specialization.
2. Inclusion of the subject: Modern architecture and contemporary trends in the curriculum as part of the historical interpretation of architectural styles and developments.
3. In the fourth and fifth years, engage academic personnel with minimum qualification of the third cycle of studies, according to the provisions of Law 80/2015 Article 59.6. It is recommended to reduce the host capacities in this study program until full compliance with the requirements on the qualification of the academic staff is guaranteed.

4. It is recommended to review the study plan to increase the weekly load per week for the course Studio Arkitekture (Architectural Design Studio) as the basic subject of training in architecture.
5. Recruiting at least one academic support staff dedicated to the study program would be necessary for the functioning of the laboratories and assistance in the teaching and research processes.
6. It is recommended to review the syllabus of professional practice in the fifth year, aiming for the student to develop a period of work in a company or institution to develop his professional skills.
7. It is recommended to draft financial plans and analyses at the department and study program level according to the provisions of the quality code *S.IV.5, K.1., K.2.*
8. It is recommended to increase the library area and further enrich the fund by guaranteeing in physical form the basic literature provided in the course syllabuses.
9. Publishing of reports or short reports of the Internal Quality Assurance as required by *SVI.5, K2.*



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X